

Arsim

**Shkollat teknike
çdoherë e më
të kërkuara**

Fq.7



**AKTAKUZA
PËR 27 PRILLIN**

**Dhunuesit e
Selës alivanosen
një pas një**

Fq.5



**Jeni një tufë
budallenjsh**

**Platini
kundër
FIFA-s**

Fq.22



www.koha.mk
Koha



**Ndryshe me
Xhevdet
Nasufin**

Fq.12-13

EDITORIAL

**Profesionalizi
mi i marrë-
dhënieve
me diasporën**



Sikur të ekzistonte një strategji e përpunuar institucionale, por edhe një planifikim më ambicioz i odave ekonomike, shumë biznese nga Maqedonia e Kosova do të mund të depërtonin dhe të bashkëpunonin me shumë kompani ekzistuese në tregun e Bashkimit Europian. Deri...

Fq.2

RAJON

**Greqia mban
të "burgosur"
mijëra
pensionistë
shqiptarë**

Fq.14

GLOBI

**Si do e
shkatërrojnë
populisët
Italinë dhe
BE-në?**

Fq.15



QEVERIA ME DIKASTERE PARALELE

**PO TË MOS ISHIN
MINISTRAT
SHQIPTARË,
A DO TË KISHTE
KOORDINATORË?**

Deri më tani nuk ka ndodhur që ndonjë shqiptar të jetë koordinator nacional për çështje të ndryshme. Ky funksion si duket është i rezervuar për kuadër maqedonas, sa herë që ka nevojë të vendoset njëfarë mbikëqyrjeje në punën e ministrave shqiptarë

Fq.4

Një "shpikje" politike pa efekte vepruese

Shkup, 6 qershor - Drejtorët ekonomikë në institucionet publike shëndetësore, ishin "shpikje" e qeverisë pararendëse dhe kjo më tepër për të rehatuar aktivistë të ndryshëm partiak, të cilët duheshin të shpërblehen për punët e bëra gjatë proceseve zgjedhore. Por, gjithsesi, ishte një dublifim i panevojshëm funksionesh, që në praktikë nuk u dëshmuar se ofron ndonjë vizion të paparë në menaxhimin e shëndetësisë

në vend. Ky post thuhet se ishte paralel me udhëheqësin e sektorit të financave, që i njëjti qëndron në institucionet shëndetësore. Edhe pas 12 viteve mbetet e hapur dilema nëse drejtorët ekonomikë nëpër institucionet shëndetësore duhet edhe më tej të figurojnë si poste, apo duhet anuluar, ndonëse procesi për zgjidhjen e organizmit menaxherial ka filluar një vit më parë...

Fq.6



EDITORIAL

PROFESIONALIZIMI I MARRËDHËNIEVE ME DIASPORËN



Emin AZEMI

Sikur të ekzistonte një strategji e përpunuar institucionale, por edhe një planifikim më ambicioz i odave ekonomike, shumë biznese nga Maqedonia e Kosova do të mund të depërtonin dhe të bashkëpunonin me shumë kompani ekzistuese në tregun e Bashkimit Europian. Deri më tani dëshirat kanë dominuar mbi veprimet konkrete, ndërkohë që vetëm në Gjermani janë të regjistruara mbi 30 mijë biznese në emër të shqiptarëve. Kjo e dhënë i përmbys të gjitha teoritë pesimiste për pamundësinë e depërtimit të produkteve e ideve tona në një treg më të gjerë europian. Ka disa lëvizje që po i ndërmerr Rrjeti i bizneseve të diasporës, mirëpo deri më tani kanë munguar rezultatet e pritura dhe proklamuar gati në çdo konferencë të organizuar nga ky Rrjet. Përderisa këto lëvizje janë më të pranishme në bizneset me prejardhje nga Kosova, kjo nuk mund të thuhet edhe për ato që vijnë nga Maqedonia. Këtu ende nuk është ngritur në shkallë institucionale bashkëpunimi ekonomik midis subjekteve afariste të këtuashme me ato nga diaspora. Ministria e Diasporës por edhe ajo e Ekonomisë nuk e ka një Sektor të veçantë që do të merrej me hulumtimin dhe detektimin e tregut të jashtëm, me theks të posaçëm një njësi që do të mund të përfshiheshin edhe segmente të caktuara afariste e menaxhuese nga diaspora. Kjo e fundit është një treg i pashfrytëzuar dhe aftësia konsumuese është e madhe, për sa kohë që kërkesat janë të orientuara në gjetjen e mundësive që në sofrat e mërgimtarëve të ofrohen produkte me prejardhje nga vendlindja. Brendimi i këtyre produkteve që do të ndiqte procedurat e njohura, do të ishte një lehtësim shtesë për hapjen e rrugëve tregtare, kurse përfituesit më të mëdhenj do të jenë prodhuesit vendorë dhe konsumatorët nga diaspora. Fundja luftërat më të mëdha tregtare sot po bëhen si të krijohen rrugë të reja për një depërtim më të madh të mallrave dhe produkteve, por me kusht që të hiqen barrierat e ndryshme doganore, fiskale etj.

Tregu u Bashkimit Europian ka rregulla strikte dhe aty nuk mund të depërtojë çfarëdo lloj produkti. Në këtë aspekt prodhuesve vendor iu bie barra të perfeksionojnë teknologjinë e prodhimit, ambalazhimin dhe marketingun. Jo pak prodhues kanë provuar të depërtojnë në këtë treg, por testet e para kanë treguar se cilësia e produkteve të këtuashme lë shumë për të dëshiruar, edhe përkundër faktit se janë gjendur rrugë për plasim. Pra nuk mjafton vetëm tregu, si dimension hapësinor, por nevojitet mbi të gjitha edhe cilësia, pa të cilën produktet vendore nuk do të mund të depërtojnë, sidomos kur ato përdoren në industrinë përpunuese e ushqimore.

Sido që të jetë rrethi i bashkëpunimit duhet zgjeruar dhe potenciali prodhues duhet kombinuar me standardet profesionale që ofrojnë cilësi. Kjo gjithsesi nuk mund të bëhet nga individët, sado vullnet mirë të jenë, por nga institutet e specializuara që japin certifikata për standarde dhe cilësi.

Bashkëpunimi ekonomik me tregjet e jashtme është natyrë komplekse. Nuk mjafton vetëm dëshira, por një sere aktivitete të ndërmarrjes që do të siguronin parakushte për këtë bashkëpunim. Nismat e deritanishme nuk kanë pasur sukses, sepse në këto aktivitete janë përfshi njerëz amatorë, të cilët përveç dëshirës, nuk posedojnë edhe ndonjë aftësi menaxhuese e profesionale. Një kuadër i edukuar që prodhimin e teston para se ta nxjerr në treg si dhe një treg që ka aftësi absorbuese, është kombinimi më i mirë që shkon në favor të gjithë këtyre politikave zhvillimore, për të cilat më shumë flitet se as punohet.

DIKUSH KA PËRFITUAR NGA BISEDIMET KOSOVË-SERBI

"Nuk di a e ka llogaritur dikush se sa i kanë kushtuar Kosovës bisedimet me Serbinë? Njëherë bisedimet e Vjenës, pastaj ato të Brukselit. Ajo që di unë është se anëtarët e delegacionit të Kosovës janë paguar nga buxheti i Kosovës për çdo takim që kanë pasur me delegacionin serb, pavarësisht se të njëjtët janë paguar nga ky buxhet edhe për funksionet që kanë ushtruar në Kosovë. Unë mund të gabo, por besoj fort se Kosovës më shumë i kanë kushtuar financiarisht bisedimet me Serbinë sesa lufta kundër Serbisë. Dëshiroj që dikush të provojë se jam gabim. Nga këto bisedime dikush ka kursyer në llogaritë e tyre bankare dhjetëra mijëra euro, dikush mbi njëqind mijë euro e dikush ka blerë makinë të shtrenjtë, është martuar për së dyti, ka blerë banesë, apo ka ndërtuar ndonjë kat shtëpie në Prishtinë. Të tillët duan që përsëri ta bëjnë delegacionin e Kosovës dhe duan që ato bisedime të zgjasin pafundësisht.

A ka mundësi që deputetët t'u bëjnë të pamundshme këtyre zyrtarëve të pafytyrë që të pasurohen edhe më tej në fatkeqësinë e Kosovës. Se fatkeqësia numër një është ta kesh Serbinë kojshi, kurse fatkeqësia numër dy është që bisedimeve me Serbinë t'u prijnë njerëzit që për qëllim kanë jo stabilizimin e raporteve me të, as stabilizimin e shtetit të Kosovës, por vetëm stabilizimin e tyre financiar", shkruan mjeku dhe shkriktari Liri Loshi në profilin e tij në Facebook.

POLITIKAT EKONOMIKE QË PRODHONJË KRIZË

"Të dhënat tregojnë se kemi vazhdim të politikave që prodhojnë vazhdimisht krizë në Maqedoni. Rasti më konkret është shpërndarja e pabarabartë e buxhetit. Shumica e shqiptarëve të Maqedonisë mendojnë se praktikat diskriminuese të institucioneve janë shtytësit kryesorë të hendekut mes etnive në Maqedoni. Korrupsioni politik dhe metodat grabitqare të zyrtarëve janë një nga agjentët kryesorë të mungesës së besimit të qytetarëve shqiptarë ndaj institucioneve. Investimet e pabarabarta në autostradat shtetërore dhe rajonale të Maqedonisë nga ana e qeverisë maqedonase, tregojnë për vazhdimin e diskriminimit etnik të popullsisë shqiptare në Maqedoni. Dy sektorë me kushte të ndryshme jetese. Çfarë tjetër mund të bëjnë përfaqësuesit politikë shqiptarë?", shkruan në profilin e tij në Facebook, analisti Selim Ibrahimimi.

VEZËT E VETËVENDOSJES!

"Kur s'guxon të merresh me ata që kanë vlarë rivalë politikë për të zaptuar pushtetin, atëherë merresh me vezët e VV-së... Kjo është tabela e prioriteteve e hipokritëve, që i shërbejnë krimit të organizuar të instaluar në nivelet më të larta politike. Kur t'i ndërroni pak prioritetet, kur kriminelët politikë do t'i quani me emrin e vërtetë, atëherë - vetëm atëherë mund ta kritikoni edhe VV-në, sepse çdo parti duhet kritikuar, nga kritika jeton e gjallërohet shoqëria", shkruan në profilin e tij në Facebook, publicisti Enver Robelli.

MEDIA Citate

Kryetari i Kuvendit të Shqipërisë, Gramoz Ruçi, ka pritur në një takim një delegacion të Kuvendit të Kosovës, të kryesuar nga nënkryetarja, Aida Dërguti. Delegacioni kosovar e informoi Ruçin mbi dy Rezolutat e miratuara ditët e fundit prej Kuvendit të Kosovës, atë "Për heqjen e roamingut ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Republikës së Shqipërisë", dhe tjetrën "Për heqjen e tërësishme të kontrollit për hyrje/daljet e shtetasve të Republikës së Kosovës dhe Republikës së Shqipërisë nëpërmjet pikave të kalimit kufitar në pikat kufitare: Vermicë, Qafë Prush, dhe Qafë Morinë".

Kryetari i Kuvendit të Shqipërisë u shpreh dakord me propozimet e delegacionit të Kuvendit të Kosovës, të përfshira në rezultatet e miratuara. "Është detyra e kuvendeve të të dy vendeve", nënvizoi Ruçi, "të lehtësojmë bashkëpunimin e gjithanshëm midis Shqipërisë e Kosovës, në mbështetje të interesave të qytetarëve.

Për të dy palët ekziston vullneti i plotë dhe i qartë politik. Këto rezoluta janë një hap pozitiv, por duhen parë me kujdes teknikalitetet e zbatimit të tyre prej qeverive dhe institucioneve të të dy vendeve".

Në takim u bisedua edhe për çështje të tjera të bashkëpunimit dypalësh në fushën e energjisë, njehsimit të diplomave, plotësimit të standardeve të integritetit etj. Të dy palët ranë dakord që për rritjen e bashkëpunimit midis të dy vendeve duhet të ndiqen praktikë më të mira të vendeve të BE-së.

Çdo marrëveshje bashkëpunimi duhet të mbështetet nga vullneti politik, forca e ligjit, detyrimet ndërkombëtare dhe të procesit të integritetit evropian dhe interesi qytetar. Kuvendet duhet dhe mund të nxisin këtë bashkëpunim edhe nëpërmjet komisioneve parlamentare. "Kuvendi i Shqipërisë dhe Kuvendi i Kosovës duhet të ushtrojnë të gjitha kompetencat e kontrollit parlamentar për përshtetimin e bashkëpunimit në të gjitha fushat", nënvizoi Kryetari i Kuvendit, Gramoz Ruçi.

(Koha Ditore, 6 qershor)

NËSE NUK E KENI DITUR...

KU KA QENË ULPIANA?

Ulpiana ka qenë qytet i krahinës ilire të Dardanisë. Rrënojat e tij janë zbuluar afër fshatit Graçanicë në rrethin e Prishtinës. Gërmimet arkeologjike kanë nxjerrë në dritë pjesë të mureve rrethuese, rrënojat e një bazilike dhe një lëndë arkeologjike të pasur. Gjatë pushtimit romak në vendbanimin e lashtë dardan u vendosën qytetarë italikë dhe mori emrin Ulpiana.

Në shek. II e.s. u ngrit në rangun e një municipi. Zhvillimin më të madh e pati në shek. III-IV. Pas tërmetit më 518 u rindërtua me mure të fuqishme dhe u zbulur me ndërtesa të reja nga perandori Justinian, prandaj u quajt Justiniana e Dytë. Qyteti vazhdoi deri në fund të kohës së vonë antike.

Kundër raportit u deklaruan kundër deputetët e shumicës parlamentare me arsyetimin se Këshilli i prokurorëve ka funksionuar me ndikim partiak, nuk ka arritur që të kryejë punën e vetë si duhet. Anëtarët socialdemokratë të komisionit kanë vënë në dukje se Këshilli gjatë një viti nuk ka ndërmarrë masa për zgjidhjen e lëndëve të cilat zvarriten në gjykata dhe nuk ka arritur të realizojë përzgjedhjen e drejtë të gjykatësve

Koha

Evis HALILI

Shkup, 6 qershor - Raporti vjetor i Këshillit të Prokurorëve nuk ka arritur të kalojë në seancën e së mërkurës të Komisionit të sistemit politik dhe marrëdhënieve mes komuniteteve. Edhe pse në këtë raport të punës një vjeçare në të cilin vlerësohej pozitivisht puna e institucioneve gjatë vitit 2017, si të azhuruar dhe efikase në zgjidhjen e shumë lëndëve dhe rekomandohej që të rritej buxheti, anëtarët e komisionit e vlerësuan negativisht.

Kundër raportit u deklaruan kundër deputetët e shumicës parlamentare me arsyetimin se Këshilli i prokurorëve ka funksionuar me ndikim partiak, nuk ka arritur që të

KOMISIONI PARLAMENTAR PËR SISTEM POLITIK

REFUZOHET RAPORTI I KËSHILLIT GJYQËSOR



kryejë punën e vetë si duhet. Anëtarët socialdemokratë të komisionit kanë vënë në dukje se Këshilli gjatë një viti nuk ka ndërmarrë masa për zgjidhjen e lëndëve të cilat zvarriten në gjykata dhe nuk ka arritur të realizojë përzgjedhjen e drejtë të gjykatësve. Ndërkohë që deputetët të VMRO-DPMNE pyetën LSDM se çfarë kanë bërë për 1 vit sa i takon pavarësisht dhe reformimit të gjyqësorit për të cilin vazhdimisht e akuzojnë se është i politizuar.

Në raportin e dorëzuar në Komisionin e sistemit politik dhe marrëdhënieve ndëretnike, ndër të tjera kërkohet konstatohet se nga

gjithsej 600 mijë lëndë (mbi 123 mijë nga viti i kaluar dhe 480 mijë të dorëzuara gjatë vitit 2017) janë zgjidhur mbi 500 mijë deri në fund të vitit të kaluar. Që sipas Raportit do të thotë se gjykatat kanë qenë të azhuruara dhe kanë punuar me efikasitet për të zgjidhur lëndë të reja, kryesisht në Gjykatën e Apelit.

Nga Këshilli Gjyqësor përmes këtij Raporti, i cili do të duhet të përpilohet edhe një herë prej tyre, kërkohet pavarësimi i i KGJ, përkatësisht të sigurohet një buxhet që do të përmbushë nevojat e gjyqësorit për realizimin e funksioneve të institucioneve të

pushtetit gjyqësor, konform me dispozitat e Ligjit për buxhetin e gjyqësorit. Po ashtu kërkohet që pjesëmarrja më aktive e përfaqësuesve të pushtetit gjyqësor në krijimin e akteve ligjore që zbatohen nëpër gjykata, si edhe të avancohet bashkëpunimi me Ministrinë e Drejtësisë, si një prej propozuesve kryesorë të aktive dhe normave ligjore nëpër gjykata.

Ndryshe, ditë më parë, Komisioni parlamentar për Transport dhe Lidhje refuzoi edhe Raportin vjetor të Radiotelevizionit të Maqedonisë, si dhe Agjencisë për Media.



Afër marrëveshjes, Athina e pret vendimin e Shkupit

Athinë, 6 qershor - Jemi afër marrëveshjes dhe në pritje të vendimeve të kryeministrit të IRJM, thotë zëvendësministri i Punëve të Jashtme të Greqisë, Janis Amanatidis në një intervistë për televizionin grek Skaj dhe sqaroi se nuk është i brengosur për vonesën në proces, pasi që "palës tjetër i duhet kohë për të shqyrtuar marrëveshjen". Zëvendësi i Koxiasit tha se marrëveshja është në interes të të dyja vendeve dhe i "zgjidh problemet në mënyrë që nuk do të krijohen konflikte në të ardhmen". "Kjo është paketë me zgjidhje, ministri zbuloi se është rreth 20 faqesh në të cilat janë përmendur të gjitha çështjet: irredentizmi, rishikimi i Kushtetutës, erga omnes, emër dhe zhvillim i agjendës për bashkëpunim, ndërsa gjithsesi edhe afati kohor në të cilin do të implementohet e gjithë kjo. Ne jemi në pritje", thotë Amanatidis dhe shfaq bindje se marrëveshja do të jetë e tillë që "do ta pranojë shumicën më të gjerë në shoqërinë greke dhe shumicën më të gjerë në parlament". Siç njofton korrespondentja e MIA-s nga Athina, lidhur me protestat e sotme, zëvendës shefi i diplomacisë greke tha se Greqia është vend demokratik dhe secili mund të protestojë dhe ta shpreh mendimin e tij, por të gjithë atyre që do të marrin pjesë në protesta i porosi se duhet të "mendojnë edhe për pasojat për moszgjidhjen e problemit". "Atë që dua t'ia them popullit është se qeveria greke e kupton ndjeshmërinë, gjithmonë e merr parasysh, por nga ana tjetër ekziston edhe interes kombëtar", tha Amanatidis dhe sqaroi se moszgjidhja e çështjes është në barë të interesave kombëtare.

Së shpejti mbledhja me Kosovën

Shkup, 6 qershor - Maqedonia dhe Kosova parashikojnë përfundim të bashkëpunimit në më shumë fusha, veçanërisht në transportin hekurudhor, diasporë, mbrojtje, inovacione, kulturë, ekonomi... E gjithë kjo do të realizohet përmes nënshkrimit të marrëveshjeve për intensifikim të bashkëpunimit në këto fusha edhe atë në seancën e parë të përbashkët të qeverive të Maqedonisë dhe të Kosovës. Zëvendëskryeministri për Çështje Evropiane, Bujar Osmani, në



seancë qeveritare ishte emëruar koordinator për seancën dhe ai së bashku me zëvendëskryetarin e Qeverisë së Kosovës, Enver

Hoxhaj, duhet të caktojnë datë për mbajtjen e seancës, informon në konferencën e djeshme për shtyp zëdhënësi qeveritar, Muha-

med Hoxha. "Mbledhja e përbashkët do të realizohet përmes nënshkrimit të marrëveshjeve për intensifikim të bashkëpunimit në këto fusha, diasporën, mbrojtjen, inovacionin, kulturën e veçanërisht në transportin hekurudhor", tha Hoxha. Kjo, shtoi ai, do jetë mbledhjen e parë e përbashkët të qeverive të Maqedonisë dhe Kosovës. Qeveria e Maqedonisë deri më tani ka mbajtur me qeveritë të Bullgarisë dhe të Shqipërisë. (Z.V)

ASGJË KONKRETE PËR TELEFONATËN E SHUMËPRITUR

QEVERIA ENDE PA QËNDRIM ZYRTAR PËR BISEDËN ZAEV-CIPRAS

Shkup, 6 qershor - Qeveria ende pa qëndrim zyrtar për atë se kur do të realizohet biseda ose takimi eventual telefonik midis kryeministrit të Maqedonisë dhe të Greqisë, Zoran Zaev dhe Aleksis Cipras në kuadër të procesit të negociatave për zgjidhjen e kontestit me emrin. Zëdhënësi i Qeverisë, Mile Boshnjakovski sot në konferencë për shtyp nuk saktësoi deri ku janë negociatat dhe nëse është i mundur takim ose bisedë telefonike të kryeministrit të Greqisë dhe të Maqedonisë deri në fund të javës. Nuk dëshiroi të japë as koment në statusin në Fejsbuk të Antonio Milloshovskit nga VMRO-DPMNE-ja.

"Nga burimet diplomatike: të enjten ose të premten (këtë javë) do të ndodh takimi Cipras - Zaev në Prespën e Vogël greke dhe nënshkrimi i Marrëveshjes për ndryshimin e emrit të Republikës së Maqedonisë. Koordinues i përgjithshëm për këtë ngjarje dhe nënshkrimin është Bojan Mariçiq, këshilltar në kabinetin e kryeministrit", është statusi

në Fejsbuk të cilin Milloshovski e publikoi në profilin e tij. "Kemi konferencë zyrtare për shtyp në Qeverinë e RM-së. Nuk lejuan të komentojmë informacione jozyrtare pa dallim nga cilat burime vijnë, derisa nuk kanë kredibilitet dhe legjitimitet", tha Boshnjakovski. Edhe në pyetjet nëse deri në fund të javës pritet bisedë ose takim Zaev-Cipras, tha se Qeveria qëndron në qëndrimet paraprakisht të thëna se nuk hyj në sferat e spekulimeve. "Mendojmë se kjo çështje është

jashtëzakonisht e rëndësishme dhe ajo që paraprakisht e paralajmëroi kryeministri mbetet si qëndrim qeveritar edhe sot", tha zëdhënësi qeveritar. Kryeministri Zaev dje deklaroi se në pyetje janë ditë kur do të ndodhë biseda telefonike midis tij dhe Ciprasit dhe shtoi se për momentin ende po krijohen rrethanat që kjo të ndodh.

Kryeministri i Maqedonisë nuk deshi të spekulojë për propozimet e pranueshme rreth emrit, as për ata të përmbajtura në pakon e

ndërmjetësuesit Methju Nimic. Procesi, sipas tij është në vetë fundin dhe shfaq besim se fundi do të jetë i suksesshëm. "Çështja është sensitive dhe do të jem i kujdesshëm. Këto ditë dua të jenë ditë të përfundimit të suksesshëm të procesit. Kur të gjitha detajet do të dakordohen, menjëherë do të ndahen. Endjeshme është tek ne, e ndjeshme është edhe në Greqi", tha Zaev dhe shtoi se megjithatë për çështjen në fund qytetarët do të vendosin në referendum.

Këta janë 6 koordinatorët kombëtarë të Zaevit

Shkup, 6 qershor - Pozita koordinator kombëtar ekziston dhe një prej mundësive që i ka Qeveria është të emërojë një lloj të tillë të funksionarëve në sferat në të cilat punon. Këtë e theksoi dje zëdhënësi i Qeverisë, Mile Boshnjakovski duke iu përgjigjur pyetjeve të gazetareve të japë koment për emërimet e fundit të koordinatorëve kombëtarë për shëndetësi dhe për kulturë. Në pozitën koordinator kombëtar për shëndetësi dje Qeveria në seancë e emëroi Goce Çakarovski, i cili ishte zëvendësministër i Shëndetësisë, ndërsa paraprakisht koordinator kombëtar i Kulturës u emërua Robert Allagjovskit, pasi u ndërrua nga funksioni ministër i Kulturës. Duke u përgjigjur në pyetjen e gazetareve për këtë se pas ndërrimit prej funksionit zëvendësministër gjegjësisht ministror të Çakarovskit dhe Allagjovskit gjegjësisht në opinion është krijuar përshtypje se Qeveria "diku i ka vendosur", Boshnjakovski theksoi se ky funksion ekziston dhe nuk është i ri, ndërsa Qeveria ka të drejtë të emërojë funksionarë të tillë në të gjitha sferat në të cilat punon.

"Koordinatori kombëtar si funksion ekziston. Kjo është pjesë e mundësive të cilat i ka Qeveria të emërojë funksionarë, në rastin konkret koordinator kombëtar në sferën e kulturës dhe koordinator kombëtar në sferën e shëndetësisë. Kjo duhet të silltet me vendimin e Qeverisë, nuk bëhet fjalë për funksione të reja", tha Boshnjakovski, sipas të cilit, nuk bëhet fjalë për mbulimin e punëve të cilat i kanë ministrat resore, por për ngritjen më të lartë të koordinimit.

Lidhur me lartësinë e pagave të cilat i marrin tha se nuk mund të tregojë me saktësi, por përmendi se është diçka nën nivelin e pagave ministrorë. Qeveria për momentin i ka katër koordinatorë kombëtarë, sipas asaj që është publikuar në ueb faqen e saj, ndërsa me dy të rinjtë numri i tyre arrin në gjashtë. Koordinator kombëtar për menaxhim kufitar është Vlladimir Pivovarov. Ai ka edhe zëvendës, Bajram Berat. Stevo Pendarovski është koordinator kombëtar për përgatitjen e Republikës së Maqedonisë për anëtarësim në NATO, Pavle Trajanov është koordinator kombëtar për zbatimin e platformës kombëtare për zvogëlimin e rreziqeve prej fatkeqësive dhe katastrofave. Koordinator kombëtar për parandalimin e ekstremizmit të dhunshëm dhe luftën kundër terrorizmit është Borçe Petrevski. Ai i ka dy zëvendës - njërin për parandalimin e ekstremizmit të dhunshëm, Xheladin Ajvazi dhe njërin për luftë kundër terrorizmit, Zllatko Apostolliki.

Deri më tani nuk ka ndodhur që ndonjë shqiptar të jetë koordinator nacional për çështje të ndryshme. Ky funksion si duket është i rezervuar për kuadër maqedonas, sa herë që ka nevojë të vendoset njëfarë mbikëqyrjeje në punën e ministrave shqiptarë

Koha

Fatos RUSHITI

Shkup, 6 qershor - Qeveria e Maqedonisë do ta ketë edhe një koordinator të ri. Kësaj radhe kultura si duket ka nevojë të koordinohet edhe më tepër dhe këtë do ta bëjë Robert Allagjovskit, i cili sa ka qene ministër si duket nuk ka mundur ti koordinoj punët si duhet. Emërimi i tij ishte krejt i befasishtëm për opinionin publik dhe kjo u bë e ditur në momentin kur në vend të tij erdhi një kuadër i Lëvizjes BESA, Asaf Ademi.

Emërimi i Allagjovskit në këtë funksion ka hapur disa dilema, të përcjella me habi se si mund të ndodhë që përkundër një strategjie nacionale në kulturë miratuar nga Qeveria, sipas së cilës do të punojë edhe Ministria e Kulturës, shpiket një dikaster paralel që do të merret me koordinime. Nëse kjo strategji është përpiluar për të vënë në funksion politikën kulturore në vend, është e paqartë se çka ka nevojë për mbivendosje të funksioneve, kur mjafton Ministria e Kulturës të jetë bartëse dhe finalizuese e këtyre politikave.

Nga Qeveria konfirmojnë për gazetën KOHA se Robert Allagjovskit para se të lë postin e ministrit është emëruar në postin e ri me propozim të kryeministrit. "Në seancën e parafundit qeveritare, me propozim të kryeministrit, Qeveria ka marrë vendim të emërojë Robert Alagjovskin koordinator nacional për zhvillimin e kulturës dhe bashkëpunim ndërministror. Kjo do të thotë se ai tashmë ka marrë funksion të ri në qeveri", thotë Muhamet Hoxha, zëdhënësi i Qeverisë.

E proklamuar si reformatore, që do të promovonte një frymë tjetër në qeverisje, Qeveria e Zaevit megjithatë nuk po tregohet immune ndaj praktikave negative të politikave të Gruevskit. Ashtu si në qeverinë pararendëse kur shpikeshin poste për të relativizuar rolin e ministrave shqiptarë, siç ishte rasti me ngritjen e njëfarë Këshilli për mbikëqyrje të reformave në gjyqësor, kur ministër i Drejtësisë ishte kuadri shqiptar, apo posti i zëvendëskryeministrit për Çështje ekonomike, që ishte sajuar për të lënë gjithashtu nën hijen ministrin shqiptar të Ekonomisë, edhe tani kryeministri Zaev e vazhdon stilin njëjtë duke emëruar koordinator të cilët pa pasur nevojë do të bëjnë

QEVERIA ME DIKASTERE PARALELE

PO TË MOS ISHIN MINISTRAT SHQIPTARË, A DO TË KISHTE KOORDINATORË?



punët e njëjta të ministrave shqiptarë.

Kur kësaj i shtojmë edhe listën e gjatë prej 47 personave të angazhuar në kabinetin e kryeministrit, mund të kuptohet se jo pa qëllim punohet në drejtim të krijimit të njëfarë vasaliteti të ministrave shqiptarë kundrejt të ashtuquajturve koordinatorë nacional, që "rastësisht" qëllonjë të jenë maqedonas. Sipas kryetarit të Shoqatës së Gazetarëve të Maqedonisë, Naser Selmani kjo dukuri e krijimit të posteve paralele flet për marginalizimin e plotë të shqiptarëve në sistemin e qeverisjes.

"Ky është sukses i partive maqedonase, të cilat duan ta bindin opinion maqedonas se shqiptarët në sistem janë vetëm për dekor. Praktikisht, partitë maqedonase rapelqejnë të kenë njerëz të paaftë nëpër pozita të rëndësishme pastaj përmes trukeve institucionale, ua marrin kompetencat dhe me këtë ua lidhin duart. Kjo gjithsesi iu konvenon këtyre njerëzve në sistem, sepse në fakt - ata as që kanë ide çfarë duhet të punojnë atje. Mund të jenë veç cirkuzant në qeveri, aq", thekson Naser Selmani. Ai kritikon ministrat shqiptarë të cilët nuk imponohen dhe më tepër punojnë për interesa individuale e grupe se sa të përgjithshme.

Sipas tij, për një gjendje të tillë kanë faj edhe liderët e partive politike shqiptare. Ndërkaq profesori i Administratë publike në Universitetin "Nëna Terezë", në Shkup, Argëtim Saliu, në aspektin formal i arsyeton veprimet e kryeministrit duke marrë si shembull shtetet e zhvilluara Perëndimore. Por në Maqedoni, sipas tij, postet paralele bëhen për të ushtruar kontroll ndaj ministrave dhe për ti diskredituar. Ai është i mendimit se në Ballkan

ende dominon mentaliteti i vjetër arkaik, ku pozicioni këshilltar dhe koordinator bëhet me qëllim të sistemit të aktivistëve apo atyre që kanë kontribuar për subjektin politik që tani më është pjesë e pushtetit. Ai shton se e gjitha qëndron tek pazari-marrëveshja politike për formim të qeverisë.

"Nëse gjatë negociatave do të arrinin që për të gjitha dikasteret saktësisht ti përcaktojnë të gjitha pozitat udhëheqëse, atëherë këto gjëra nuk ndodhin. Por nga përvoja, partive politike shqiptare nuk u shkon mendja për pozicionet tjera për koordinator apo këshilltar, por për eshalonin e parë, të dytë dhe të tretë", thotë Argëtim Saliu.

Sipas Sociologut politik Ali Pajaziti emërimet e reja qeveritare janë entitete sipërane mbi ministrat shqiptarë që, siç thotë ai, reflektojnë mosbesim ndaj kuadrove shqiptar.

"Fenomeni apo emërimi 'koordinator nacional për...', 'këshill për mbikëqyrje', janë entitete sipërane mbi ministrat shqiptarë e që reflektojnë një psikologji dhe mendësi mosbesimi ndaj kuadrove politike dhe profesionale shqiptare, për raporte jokohezive dhe joorganike brenda Qeverisë Zaev. Këto kreatura të panatyrshme dhe me ngjyrimë segregacioniste flasin për politikbërje etnike, etnocentrike, jo nacionale-shtetërore, por, ndoshta edhe për pafuqinë e faktorit shqiptar në ekzekutiv, të jemi vetëkritikë, ndoshta janë 'efekt' i dobësive të treguara nga kuadrot partiake tona brenda viteve, që tani gjenerojnë trupa sui generis, absurdë, që perceptohet si njëfarë 'asistence e detyrueshme' apo 'kontroll që i siguron qeverisë efijencë më të madhe', thotë Ali Pajaziti.

ALI PAJAZITI

Fenomeni apo emërimi 'koordinator nacional për...', 'këshill për mbikëqyrje', janë entitete sipërane mbi ministrat shqiptarë e që reflektojnë një psikologji dhe mendësi mosbesimi ndaj kuadrove politike dhe profesionale shqiptare, për raporte jokohezive dhe joorganike brenda Qeverisë Zaev

ARGËTIM SALIU

Nëse gjatë negociatave do të arrinin që për të gjitha dikasteret saktësisht ti përcaktojnë të gjitha pozitat udhëheqëse, atëherë këto gjëra nuk ndodhin. Por nga përvoja, partive politike shqiptare nuk u shkon mendja për pozicionet tjera për koordinator apo këshilltar, por për eshalonin e parë, të dytë dhe të tretë

NASER SELMANI

Ky është sukses i partive maqedonase, të cilat duan ta bindin opinion maqedonas se shqiptarët në sistem janë vetëm për dekor. Praktikisht, partitë maqedonase rapelqejnë të kenë njerëz të paaftë nëpër pozita të rëndësishme pastaj përmes trukeve institucionale, ua marrin kompetencat dhe me këtë ua lidhin duart

RIKUALIFIKOHET AKTAKUZA PËR 27 PRILLIN

DHUNUESIT E SELËS ALIVANOSËN NJË PAS NJË

Gjatë rikualifikimit të aktakuzës për rastin Sela, përfaqësuesi i Prokurorisë së Shkupit, prokurori Jakimovski theksoi se Cejo Gjeorgjievski dhe Stojan Pavlleviski, në të ardhmen do të gjykohen për veprën penale "dhunë", ndërsa Kire Gjeorgjievski, Oliver Oshakovski, Aleksandar Janevski - Toshta, Kosta Dellov, Andrej Micov, Nikolla Vojminovski dhe Nikollçe Dimitrievski vazhdojnë të akuzohen për veprën "tentim vrasje"



pozojmë që i akuzuari Senkov të lirohet nga aktakuza", tha prokurori Jakimovski.

Gjatë rikualifikimit të aktakuzës për rastin Sela, përfaqësuesi i Prokurorisë së Shkupit, prokurori Jakimovski theksoi se Cejo Gjeorgjievski dhe Stojan Pavlleviski, në të ardhmen do të gjykohen për veprën penale "dhunë". Përderisa, siç theksoi ai, të akuzuarit Kire Gjeorgjievski, Oliver Oshakovski, Aleksandar Janevski - Toshta, Kosta Dellov, Andrej Micov (njëri prej personave me maskë), Nikolla Vojminovski dhe Nikollçe Dimitrievski vazhdojnë të akuzohen për veprën "tentim vrasje" ndaj Selës. Ndaj këtij vendimi përfundimtar të Prokurorisë së Shkupit, para se të jepen fjalët përfundimtare, më ashpër ka reaguar i akuzuari Aleksandar Janevski - Toshta.

"Nuk e kam të qartë se pse unë po akuzohem për vrasje. Të gjitha video dhe dëshmitë e dëshmuar faktin se unë nuk kam lidhje me këtë vepër që po më ngarkohet. Ndoshta arsye e vetme se pse unë po akuzohem për këtë vepër është përkatësia ime politike si një 'vmrovec' dhe themelues i saj. Gjithçka në rastin tim është orkestruar nga lartë. Ata e kanë dhënë urdhrin. Trup duhet t'ju vijë. Pas këtij qëndrimi lirish të dërgoni në litar", tha Janevski, në fjalimin e tij para gjykatës. I revoltuar tej mase se pse prokuroria nuk e ka rikualifikuar aktakuzën edhe për rastin e tij, i

akuzuari Janevski, për një çast e humbi vetëdijen, me çka seanca u anulua. Dy apo tre seanca e radhës, njëra prej të cilëve është caktuar për më 11 qershor, pritet të japin verdiktin përfundimtar gjyqësor për sulmin ndaj deputeti Ziadin Sela, mbrëmjen e 27 prillit të vitit 2017.

Ndryshe, deri më tani me propozim të prokurorisë në seancë gjyqësor kanë paraqitur një varg dëshmitarë, në mesin e të cilëve deputetë, ministra dhe gazetarë, të cilët nga afër e kanë përjetuar sulmin e dhunshëm të 27 prillit. Rrëfimet e dëshmitarë në rastin Sela, në masë të madhe e kanë sqaruar rolin e të akuzuarve në ngjarjet e 27 prillit, megjithatë video-xhirimi i prezantuar në seancën e kaluar e vulosi faktin se kush në të vërtetë ka marrë pjesë në linçimin e kreu të ASH-së.

Goditjet më të rënda, siç potencoi të mërkurën prokurori Jakimovski, në bazë të analizave dhe dëshmitë të mbledhura, deputetit Sela i kanë shkaktuar të akuzuari Andrej Micov dhe Kire Gjeorgjievski. I akuzuari Micov, sipas Prokurorisë së Shkupi, goditjen e parë të rëndë Selës ia ka shkaktuar gjatë kohës kur ai në sallën për shtyp në Parlament e kishte humbur vetëdijen. Nga ana tjetër, veprimet monstruoze të të akuzuarit Kire Gjeorgjievski, kanë kulminuar kur deputeti Sela ka qenë i shtrirë para sallës së Klubit të Deputetëve në Parlament.

KRONIKË

Kapet duke transportuar dru, arrestohet 39 vjeçari

Pjesëtarë të policisë nga Sektori për Punë të Brendshme në Tetovë, të martën rreth orës 18.00, në rrugën e pa asfaltuar mbi fshatin Xhepçisht, kanë vërejtur dhe ndaluar një Traktor "Ferguson IMT 533", i drejtuar nga 39 vjeçari T.D. nga fshati Xhepçisht. Në traktor ka patur të ngarkuar rreth një metër kub dru për ngrohje dhe një sharrë motorike, të cilat në mënyrë ilegale janë transportuar pa dokumentacionin e nevojshëm. Për këtë shkak janë konfiskuar me vërtetim dhe dorëzuar në Policinë pyjore. 39 vjeçari T.D. është arrestuar dhe mbajtur për procedurë të mëtejshme.

Aksidentohet 16 vjeçari me motoçikletë

Në udhëkryqin e rrugëve "Ivo Lolla Ribar" dhe "Orce Nikolov" në Tetovë, të martën mbrëma rreth orës 21 e 50 minuta, ka ndodhur aksident trafiku në të cilin kanë marrë pjesë, vetura e tipit "Mercedes" me targa të Tetovës, e drejtuar nga 33 vjeçari M.U. nga Tetova, dhe motoçikletë "Sampo" me targa të Shkupit, e drejtuar nga një 16 vjeçarë nga Tetova.

Në këtë aksident, bashkëudhëtarin në motoçikletë, gjithashtu një 16 vjeçarë nga Tetova, ka marrë lëndime trupore, dhe është dërguar në Spitalin klinik të Tetovës, për marrjen e ndihmës mjekësore. Pas kryerjes së hetimeve, punohet në zbardhjen e shkaqeve të aksidentit, rrethanat dhe detaje tjera lidhur me aksidentin.

(U.H)

Koha

Omer XHAFFERI

Shkup, 6 qershor - Jo të gjithë të akuzuarit për sulmin ndaj deputeti Ziadin Sela do të gjykohen për "tentim vrasje". Prokurori Darko Jakimovski, në seancën e mbajtur të mërkurën para Trupit gjykues u deklarua se nga analiza e provave të fundit, është vërtetuar qartë përfshirja e të akuzuarve në dhunën e ushtruar ndaj deputetit Sela dhe për këtë shkak, propozoi rikualifikimin e aktakuzës. Në këtë drejtim, ai shtoi se dëshmitë dhe faktet e reja në rastin Sela kanë sqaruar se i akuzuari Sasho Senkov, as që ka marrë pjesë në dhunën ndaj deputetëve, sigurimit të tyre dhe gazetarëve dhe aq më pak - në tërheqjen e kreu të Aleancës për Shqiptar.

"Video materialin e prezantuar në seancën e kaluar e kemi analizuar sekondë pas sekondë. Kështu që është vërtetuar se i akuzuari Senkov nuk ka marrë pjesë në sulmin ndaj Selës. Në video, ai shihet se si tenton t'i largojë dhunuesit nga deputeti Sela, megjithatë për shkak të trumës së madhe, nuk ka arritur. Kësisoj, pro-

VAZHDOJNË RRËFIMET E DËSHMITARËVE TË DHUNËS NË QENDËR

Policia i dirigjoi huliganët

Shkup, 6 qershor - Në Gjykatën e re Penale, dje me dëgjimin e dëshmitarëve vazhdoi gjykimi për lëndën "Dhunë në Qendër". Në pyetjet e prokurores Fatime Fetai u përgjigj Cvetanka Simonovska, këshilltare e LSDM-së në komunën Qendër në periudhën kur ndodhi dhuna në barakat e komunës.

Simonovska tha se gjatë seancës së Këshillit një turmë e njerëzve kishin brohoritur fjalë të ndyta me kërcënime drejt këshill-

tarëve të LSDM-së. Simonovska kishte vërejtur se sa herë kishte folur kryetari i Këshillit Miroslav Shipoviq, këshilltarja e VMRO-DPMNE-së, Daniella Rangellova i kishte bërë zile në telefonin celular. Sipas dëshmitarit, ai ishte sulm i organizuar, ndërsa qëllimi ishte të largoheshin katër pikat e seancës së Këshillit për plane urbanistike në Qendër. Gjatë seancës turma i kishte thyer dritaret me çka ishte lënduar një këshilltare. Simonov-

ska u kujtua se protestuesit kishin dy sirena të cilat nuk dinin se si t'i përdorin, por me ndihmën e policisë ata arritën t'i aktivizojnë dhe të bëjnë zhurmë. Kishin dëgjuar kërcënime se do të digjen dhe se nuk do të dalin të gjallë, si dhe fjalë të tjera të shëmtuara.

Fetai e pyeti këshilltaren e cila kishte brohoritur në turmë, ndërsa Simonovska tha se ka turp të thotë, por me insistim të prokurores tha se zotëria i cili i kishte he-

pur pantallonat duke treguar organin gjenital kishte brohoritur fjalë më të shëmtuara. Dëshmitarja, e cila është inxhinierë arkitekthe, tha se vendosja jashtë fuqie e planit për ringun e parë në Qendër nuk parashihte rrënimin e kishës Shën Konstantini dhe Elena. Të akuzuar në rastin "Dhunë në Qendër" janë ish-kryeministri Nikolla Gruevski, ish-ministri i Transportit dhe Lidhjeve, Mile Janakieski, deputetja e VMRO-

DPNE-së Daniella Rangellova, si dhe nëntë persona.

Ata akuzohen për dhunën e shkaktuar e cila ndodhi gjatë protestave para komunës Qendër në qershor të vitit 2013. Në seancat e kaluara për këtë lëndë, fajin e pranoi i akuzuari i katërt Tomislav Lazarov dhe i akuzuari i pestë Jordan Ristevski dhe morën dënime me kusht. Për të akuzuarin e shtatë, Dimçe Kërstev, vazhdon procedurë e ndarë. (O.Xh)

Parku

teknologjik në përdorim deri në fund të vitit

Shkup, 6 qershor - Duam ta promovojmë Maqedoninë si vend për testim të IKT teknologjive të reja. Kombinimi i institucioneve të hapura, kapaciteteve për hulumtim dhe zhvillim, profesionistëve me kualifikime të larta, përkrahje financiare dhe logjistike për kompani të reja inovative dhe rrethina të reja investuese energjetike, është destinacion i përkryer madje edhe për IKT kompanitë me zhvillim të lartë t'i testojnë teknologjitë e tyre të reja në Maqedoni, tha sot ministri i Shoqërisë Informatike dhe Administratës, Damjan Mančevski. Mančevski ka marrë pjesë në GEANT info ditën dhe në promovimin e GEANT si rrjet pan-evropian akademik dhe hulumtues. Para pjesëmarrësve të ngjarjes, paralajmëroi se Parku teknologjik duhet të lëshohet në përdorim deri në fund të vitit. Sipas ministrit, transformimi digjital është proces i shtrenjtë dhe kompleks për të cilin të domosdoshme janë investimet në infrastrukturë dhe resurset njerëzore. "Parku teknologjik është një nga projektet për sigurimin e përkrahjes infrastrukturore dhe financiare për aktivitetet inovative. Qeveria do të veprojë si fond engjëllor i cili do t'i përkrahë kompanitë e reja në fazat e tyre më të rrezikshme të zhvillimit. Vendosja e parkut modern për shkencë dhe teknologji është iniciativa e cila ka për qëllim ta përforcojë konkurrencën e industrive udhëheqëse në vend dhe ta nxitë zhvillimin e sektoreve të reja", përmendi ministri. Parku teknologjik është masë për përkrahje të ndërmarrjeve mikro, të vogla dhe të mesme si një nga tre shtyllat e Planit për rritje ekonomike të Maqedonisë. Dy shtyllat e tjera kanë të bëjnë me masat për përkrahje financiare të grinfield dhe braunfield investimeve të reja, krijimin e vendeve të reja të punës dhe më të mira, zhvillim teknologjik dhe hulumtim, si dhe përmirësim të bashkëpunimit afarist dhe përkrahje të pakthyeshme për kompanitë.

"Këto dy shtylla do të implementohen përmes Ligjit të ri për përkrahje financiare të investimeve", informon Mančevski sipas të cilit përfitimet e realizimit të masave të parashikuara në këto tre shtylla janë të mëdha: Përkrahja e ndërmarrjeve të reja, zvogëlimi i papunësisë, përforsimi i konkurrencës, efikasiteti dhe produktiviteti, nxitja e bashkëpunimit mes kompanive vendore dhe të huaja, si dhe rritja e investimeve.

KOTËSIA E DREJTORËVE EKONOMIKË NË SHËNDETËSI

NJË "SHPIKJE" POLITIKE PA EFEKTE VEPRUESE

Në ndryshimet dhe plotësimet e Ligjit për mbrojtje shëndetësore, parashihet pezullimi i postit të drejtorit ekonomik në institucionet publike shëndetësore, i cili përpos bllokadave, nuk kanë sjellë kurrfarë risie në efikasitetin menaxhues të këtyre institucioneve

Koha Delvina KËRLUKU

Shkup, 6 qershor - Drejtorët ekonomikë në institucionet publike shëndetësore, ishin "shpikje" e qeverisë pararendëse dhe kjo më tepër për të rehatuar aktivistët të ndryshëm partiak, të cilët duheshin të shpërblehen për punët e bëra gjatë proceseve zgjedhore. Por, gjithsesi, ishte një dublifikim i panevojshëm funksionesh, që në praktikë nuk u dëshmuar se ofron ndonjë vizion të paparë në menaxhimin e shëndetësisë në vend. Ky post thuhet se ishte paralel me udhëheqësin e sektorit të financave, që i njëjti qëndron në institucionet shëndetësore.

NËNSHKRIMI BLOKUES

Edhe pas 12 viteve mbetet e hapur dilema nëse drejtorët ekonomikë nëpër institucionet shëndetësore duhet edhe më tej të figurojnë si poste, apo duhet anuluar, ndonëse procesi për zgjidhjen e organizimit menaxherial ka filluar një vit më parë.

Sikundër dihet në Maqedoni kanë qenë mbi 1000 drejtorë ekonomikë dhe intenca ishte që ata të përmirësojnë kushtet në institucionin e shëndetit publik. Por, në anën tjetër një dublifikim i tillë i funksioneve ka rënduar buxhetin e shtetit



SHABAN MEMETI

Roli i drejtorit të ekonomisë kryesisht në institucione publike shëndetësore ka pasur dhe ka të njëjtin rol si drejtori profesional, por që vështirë ka funksionuar. Bashkëpunimi në institucione të caktuara po ashtu ka qenë shumë i vështirë në mes drejtorit profesional dhe ekonomik dhe ky i fundit ka pasur të njëjtat të ardhura si drejtori profesional. Ka pasur bllokada të caktuara të funksionimit të institucioneve, flas për disa institucione, që kanë qenë të kategorisë së përcaktimit politik, të emërimit të tyre...

Këta persona nuk duhet të jenë në rolin e drejtorit, por duhet të gjendet një model tjetër i organizimit të institucioneve publike shëndetësore, i cili do të jetë në rolin e ekonomistit, mendon Memeti.

Vetëm në Shkup, në 15 institucione shëndetësore publike, duke përfshirë Klinikën e fëmijëve, Endokrinologjinë, Radiologjinë, si dhe disa qendra të tjera shëndetësore, ende udhëhiqen nga dy drejtorë, ndërkohë që Ministra e Shëndetësisë po e shqyrton mundësinë e pezullimit të pozitës së drejtorit ekonomik në institucionet shëndetësore, dhe kjo do të bëhet me ndryshimet dhe plotësimet reja të Ligjit për mbrojtje shëndetësore, i cili është në procedurë.

me fonde që nuk kanë pasur arsyeshmëri të duhur ekonomike financiare. Drejtorët e tillë paguheshin nga 1000 euro në muaj.

Edhe pse në shumë spitale tashmë është larguar ky post, ai më herët ka luajtur rol të rëndësishëm, sepse asnjë vendim nuk ka mundur të hyj në fuqi pa nënshkrimin e tij.

Drejtori i Spitalit të përgjithshëm në Strugë, dr. Asim Musa, për gazetën "Koha" thotë se kure e ka pranuar këtë post, nuk ka pasur drejtor të ekonomisë.

"Jam drejtor në spitalin e përgjithshëm që nga viti 2015. Në mandatin tim nuk u ndesha me drejtor të ekonomisë, sepse e kishin tërhequr funksionin si të tillë. Tani çështjet e ekonomisë i menaxhon udhëheqësi financiar, i cili nuk ka kompetenca që të bllokojë punën e drejtorit të përgjithshëm", nënvizon dr. Musa. Ai sqaron se drejtori i ekonomisë ka qenë i njëjtë si udhëheqësi i financave, gjë që asgjë nuk ka pas fuqi ekzekutive pa nënshkrimin dhe ai.

Në institucionet publike shëndetësore duhet të ekzistojë sektor i veçantë i ekonomisë, i udhëhequr nga një person që dallon si post nga drejtori profesional i mjekësisë, thotë Shaban Memeti, drejtor i Institutit të Shëndetit Publik, i cili

nënvizon se posti i drejtorit ekonomik ka funksionuar shumë vështirë.

SEKTOR FINANCIAR, EJO DREJTOR EKONOMIK

"Roli i drejtorit të ekonomisë kryesisht në institucione publike shëndetësore ka pasur dhe ka të njëjtin rol si drejtori profesional, por që vështirë ka funksionuar. Bashkëpunimi në institucione të caktuara po ashtu ka qenë shumë i vështirë në mes drejtorit profesional dhe ekonomik dhe ky i fundit ka pasur të njëjtat të ardhura si drejtori profesional. Ka pasur bllokada të caktuara të funksionimit të institucioneve, flas për disa institucione, që kanë qenë të kategorisë së përcaktimit politik, të emërimit të tyre", sqaron doktor Memeti. Profili i drejtuesit të institucionit shëndetësor publik, sipas Memetit, duhet të jetë një menaxher i mirëfilltë që të dijë të funksionojë. "Roli i drejtorit ekonomik që ka mbuluar fushën e financave, ka funksionuar edhe më herët, por jo në rangun e drejtorit, por në udhëheqjen e sektorit, të re-partit. Kështu që mbrojtje qëndrimin, si udhëheqës i ISHP-së, por edhe si kirurg, që duhet të forcohen kapacitetet profesionale – medicinale, të institucioneve publike shëndetësore", thotë Memeti.

Shtrenjtimi i naftës, i pritur

Ohër, 6 qershor - Rritja e çmimit të naftës në bursat botërore nuk pritet të shkaktojë ndryshime inflacioniste, vlerëson guvernatorja e Bankës Popullore të Republikës së Maqedonisë, Anita Angelovska-Bezhoska. "Për ne si Bankë Qendrore, rritja e çmimit të naftës është e pritur. Në fazën e projeksioneve makroekonomike ne i ndjekim të

gjitha lëvizjet vijuese, pritjet e analistëve, ashtu që çmimi nuk është për t'u befusuar, edhe më shumë që pas disa vitesh ulje të çmimit të naftës, vitin e kaluar u tregua trend në rritje", tha Angelovska-Bezhoska duke u përgjigjur në pyetje të gazetarëve në Ohër ku po mbahet Konferenca e 11-të për pagesë dhe infrastrukturë të tregut "Koha është për

digjitalizim". Ajo theksoi se nafta është vetëm një prej komponentëve që hyjnë në indeksin e inflacionit, i cili nuk ka efekt të rëndësishëm direkt dhe vetë ndryshimet e çmimit të saj nuk do të duhej të shkaktojnë presione më të mëdha të inflacionit. "Megjithatë, shumë do të varet sa presionet nga ai efekt i çmimit tek nafta do të transmetohet tek

prodhimet tjera pra prej atje eventualisht të shihet ndonjë efekt sekondar. Duke i pasur parasysh të gjitha lëvizjet dhe pritjet me çmimet e naftës, projeksioni ynë si bankë qendrore për këtë vit është inflacion prej dy për qind që është në linjë edhe me qëllimin tonë të vendosur për mbajtjen e inflacionit të ulët dhe stabil", potencoi ajo.

ARSIMI PROFESIONAL NË MAQEDONI DHE RAJON

SHKOLLAT TEKNIKE ÇDOHERË E MË TË KËRKUARA

Biljana Gligorova, drejtoresha e SHM "Vllado Tasevski", thotë se janë në nivele të kënaqshme si cilësia e shkollimit ashtu edhe interesimi i nxënësve. Madje, sa i përket kësaj të fundit në Maqedoni, thotë se ka një trend pozitiv

Koha Laura PAPANIKU

Shkup, 6 qershor - Shkollat e mesme të teknikës jo vetëm në Maqedoni por në të gjitha shtete e rajonit po zgjojnë interesimi gjithnjë e më të madh të nxënësve. Kjo, sigurisht për shkak të rritjes së cilësisë së mësimdhënies, përmirësimit të kushteve, pajisjes së shkollave me laboratorë dhe mjete adekuate, si dhe për shkak të kërkesave të tregut të punës për absorbimi e kuadrove me profilet që nxjerrin shkollat teknike dhe elektroteknike. Kjo u tha mes tjerash në Konferencën e parë ndërkombëtare të shkollave teknike që u organizua në Shkup, në përkujdesjen e Shkolles së Mesme Elektroteknike "Vllado Tasevski" në Shkup. Por, vëmendja duhet të kthehet tek aftësimi i këtyre kuadrove me shkathtësi dhe kompetenca profesionale konformë profileve të shkollimit. Sepse, programet mësimore, sikurse vërejt mysafiri nga Greqia, janë shumë të mira dhe kjo vlen për të gjitha shtete e rajonit.

"Shkollat teknike dhe elektroteknike janë përafërsisht të njëjta në të gjitha shtete tona. Kanë programe shumë të mira, kushtet gjithashtu të mira. Mirëpo, në të gjitha këto shtete duhet të përmirësohet komponenti e pajisjes së kuadrove me shkathtësi profesionale", u shpreh ai. Këtë mendim ndanë edhe pjesëmarrësit tjerë nga Serbia, Bullgaria, Shqipëria dhe Maqedonia. Biljana Gligorova, drejtoresha e SHM "Vllado Tasevski", thotë se janë në nivele të kënaqshme si cilësia e shkollimit ashtu edhe interesimi i nxënësve. Madje, sa i përket kësaj të fundit në Maqedoni, thotë se ka një trend pozitiv. "Nëse deri para 4-5 vitesh formonim paralele me nga 13 nxënës në klasë, vitin që shkoi si rezultat i interesimit të shtuar u formuam paralelet me nga 34 nxënës në klasë, pra me aq sa është maksimumi i lejuar me ligj", pohon Gligorova. Kushtet për realizimin e këtij lloj shkollimi profesional, i cili është tepër i kushtueshëm, sipas saj janë gjithashtu të mira. "Sigurisht se nuk mund të ecim në të njëjtin hap me zhvillimet teknologjike që ndodhin në botë, por mundohemi që të përmirësojmë çdo herë e më shumë kushte e mësimin



duke sofistikuat mjete e punës", sqaron drejtoresha, ndërsa thotë se për këtë qëllim shfrytëzohen edhe fondet e projekteve të ndryshme që ndan Bashkimi Evropian apo përmes pjesëmarrjes në projekte të përbashkëta me shtete të veçanta. Shqipëria duket se është kthyer në një histori suksesi në këtë drejtim. Elviona Dimroçi, drejtoreshë e Shkolles së Mesme Teknike - Elektrike "Gjergj Çanço" në Tiranë, thotë se mbështetja teknike përmes projekteve dhe fondeve të jashtme është një mundësi që duhet shfrytëzuar. Para dy javësh, pranuar në shkollë dy laboratorë të teknologjisë më të fundit digjitale, të cilat është e vështirë të gjenden edhe në shkollat e shteteve të zhvilluara evropiane, pohon ajo, ndërsa vëren se kjo shkollë vazhdon edhe më tej traditën e nxjerrjes së kuadrove për gjithë Shqipërinë. "Vit pas viti, jo vetëm

që e bartim këtë traditë për edhe përmirësojmë cilësinë e kuadrove që dalin nga shkolla jonë", plotëson më tej. Shkollat profesionale të teknikës, elektrikes, informacionit të komunikimit dhe elektroteknikës, janë për momentin në fazën e përmirësimit të cilësisë në bashkëpunim me shtete e Bashkimit Evropian, të cilat financojnë jo vetëm në pajisjen e shkollave me laboratorë por edhe në trajnimin e kuadrove. Evropa edhe ashtu shkon në drejtim të krijimit të një tregu të përbashkët të punës dhe për këtë është shumë e rëndësishme unifikimi i sistemeve arsimore, respektivisht programeve mësimore të shkollave profesionale dhe paralelisht kësaj nxjerrjes së kuadrove të cilët do të jenë në gjendje të ushtrojnë profesionin me të gjitha dhuntitë dhe shkathtësitë e nevojshme. Pa këtë, do të jetë e pamundur të gjendet punë si në shtete e BE-së ashtu edhe në rajon.

që e bartim këtë traditë për edhe përmirësojmë cilësinë e kuadrove që dalin nga shkolla jonë", plotëson më tej. Shkollat profesionale të teknikës, elektrikes, informacionit të komunikimit dhe elektroteknikës, janë për momentin në fazën e përmirësimit të cilësisë në bashkëpunim me shtete e Bashkimit Evropian, të cilat financojnë jo vetëm në pajisjen e shkollave me laboratorë por edhe në trajnimin e kuadrove. Evropa edhe ashtu shkon në drejtim të krijimit të një tregu të përbashkët të punës dhe për këtë është shumë e rëndësishme unifikimi i sistemeve arsimore, respektivisht programeve mësimore të shkollave profesionale dhe paralelisht kësaj nxjerrjes së kuadrove të cilët do të jenë në gjendje të ushtrojnë profesionin me të gjitha dhuntitë dhe shkathtësitë e nevojshme. Pa këtë, do të jetë e pamundur të gjendet punë si në shtete e BE-së ashtu edhe në rajon.

Për shkak të mosbesimit, korrupsioni në universitete nuk denoncohet

Sipas profesores Besa Arifi nga UEJL, për denoncimin më të vështirë të korrupsionit në universitete, përveç mosinformimit - vend të vetin ka edhe mosbesimi i personave dhe studentëve të prekur se një rast i tillë mund të sjellë deri në fund

Tetovë, 6 qershor - Në dy vitet e kaluara nga vlefshmëria e Ligjit për mbrojtjen e treguesve, për korrupsion në arsimin e lartë në Maqedoni nuk ka asnjë denoncim. Këtë e theksuan pjesëmarrësit në trajnimin e sotëm me temë "Rritja e kapaciteteve të universiteteve për zbatimin e Ligjit për mbrojtjen e treguesve si vegël për parandalim të korrupsionit në arsimin e lartë në Maqedoni", që po mbahet në rektoratin e Universitetit të Evropës Juglindore në Tetovë.

Trajnimi është pjesë e projektit "A do të ketë 'tregues' në universitetet?", ndërsa e organizon Instituti për Hulumtime Strategjike dhe Edukim - ISIE nga Shkupi në bashkëpunim me Fakultetin Juridik të EJLS-së. Sipas Aleksandra Dejanovska-Tredafilova, prof. nga Fakulteti Juridik në Universitetin "Shën Cirili dhe Metodi" në Shkup, shkak kryesor për atë që nuk shfrytëzohen mundësitë që ky ligj ua jep spiunëve për mbrojtjen e tyre gjatë denoncimit të rasteve të korrupsionit në arsimin e lartë në Maqedoni është informimi i pamjaftueshëm.

Profesoresha Tredafilova theksoi se në dhjetor të vitit kaluar është nënshkruar Memorandum për bashkëpunim të të gjitha universiteteve shtetërore dhe private nga Maqedonia me ministren e atëhershme të Arsimit dhe Shkencës, Renata Deskoska për intensifikimin e aktiviteteve dhe njohje më të madhe të të gjithë të

intreresuarve rreth mundësisë të këtij ligji për treguesit e korrupsionit në institucionet e arsimit të lartë. Sipas profesores Besa Arifi nga UEJL, për denoncimin më të vështirë të korrupsionit në universitete, përveç mosinformimit - vend të vetin ka edhe mosbesimi i personave dhe studentëve të prekur se një rast i tillë mund të sjellë deri në fund.

Aktivitetet e ISIE për projektin "A do të ketë 'tregues' në universitetet? Mundësitë e ligjit për mbrojtjen e treguesve dhe parandalimi i korrupsionit në arsimin e lartë në Maqedoni" janë mbështetur nga Ambasada e SHBA-së në Maqedoni.

intreresuarve rreth mundësisë të këtij ligji për treguesit e korrupsionit në institucionet e arsimit të lartë. Sipas profesores Besa Arifi nga UEJL, për denoncimin më të vështirë të korrupsionit në universitete, përveç mosinformimit - vend të vetin ka edhe mosbesimi i personave dhe studentëve të prekur se një rast i tillë mund të sjellë deri në fund.

Aktivitetet e ISIE për projektin "A do të ketë 'tregues' në universitetet? Mundësitë e ligjit për mbrojtjen e treguesve dhe parandalimi i korrupsionit në arsimin e lartë në Maqedoni" janë mbështetur nga Ambasada e SHBA-së në Maqedoni.

KSL FILLOI FUSHATËN "PAGË E MIRË PËR JETË TË MIRË"

Të vendosur për paga më të mëdha

Shkup, 6 qershor - Konfederata e sindikatave të lira filloi fushatë për paga më të mëdha në sektorin publik "Pagë e mirë për jetë të mirë", e cila do të zhvillohet në rrjetet sociale, vizitat, tubimet dhe konferencat në shumë qytete pavarësisht kërkesës për anëtarësim. "Do t'i themi stop nënvlerësimit dhe injorimit në sektorin publik i cili tashmë u bë kategori sociale, stop diskriminimit dhe presionit politik në sektorin publik, për lëshim të pozitës së fuqisë dhe punësim të personave tjerë, për presionet ndaj liderëve sindikal", tha në konferencën e sotme për shtyp drejtori i KSL-së, Bllagoja Ralповski, duke mos i përjashtuar aktivitetet të shndërrohen në veprim sindikal të radikalizuar. Siç theksoi ai, nuk do të tërhiqen nga kërkesat për aranzhim të pagave në sektorin publik sipas përqindjes për rritje të pagës minimale, rritje të pagave në administratën publike pa diskriminim të sektorëve të caktuara gjatë ribalancit të ardhshëm të Buxhetit, për respektimin e marrëveshjeve kolektive veçanërisht në pjesën e koeficientit për pagesë të pagës. Si sindikatë, potencon Ralповski, jemi të shqetësuar nga presioni me të cilin përballen anëtarët tanë për anëtarësim ose mos anëtarësimi nga sindikatat, kërcënime për masa ndëshkuese nëse nuk veprohet sipas urdhrave të njerëzve të fuqishëm, degradim, manipulim, shqetësim psikik, sulm në organizatat sindikale, ndërmarrja e tyre me kërcënime dhe fuqi, ndërprerja e paligjshme e tarifës së anëtarësimit të subjekteve tona juridike, marrja e dokumentacionit të organizatave sindikale nga ana e drejtorëve të emëruar nga Qeveria. Shembuj më të ashpër, plotësoi, është shkarkimi i disa liderëve sindikalë duke e përfshirë edhe kryetarin e KSL-së nga pozita e nëpunësit shtetëror, që vetvetiu dërgon porosi deri te anëtarësimi për fuqinë e tyre, braktisjen dhe shkatërrimin e sindikatës sonë dhe shmangien e obligimeve ligjore". Duke iu përgjigjur pyetjes së gazetareve Ralповski tha se paga mesatare në sektorin publik është rreth 18.000 denarë, ndërsa më të diskriminuar janë mësimdhënësit, profesorët, të punësuarit në kopshite, nëpunësit shtetërorë. Për problemet dhe kërkesat para dy muajve kanë biseduar me kryeministrin Zoran Zaev, por, tha, nuk ka përmirësime në punët. KSL përsëriti se mbetet edhe në kërkesën për pagesë të K-15 në sektorin publik, por që nuk ka njoftim për fillim të negociatave për marrëveshjen kolektive në sektorin publik dhe realizimin e ndonjë gjëje të tillë.



Агенција за вработување на
Република Македонија

Agjencia e Punësimit e RM më 07.06.2018 shpall:

SHPALLJE PUBLIKE

Për personat e papunësuar të cilët duan të fillojnë biznesin e tyre nëpërmjet Projektit të vetëpunësimit me kreditim. Të drejtë për aplikim kanë të gjithë personat e evidentuar si të papunë, pa marrë parasysh sa kohë ka qenë i pa punë, gjegjësisht persona të papunësuar që në mënyrë aktive kërkojnë punë, dhe që janë në evidencë një ditë para shpalljes publike.

Kushtet sipas të cilave mund të merren mjetet kreditore janë siç vijojnë:

- Për veprimtaritë me volum më të vogël, çdo hapje e re e vendit të punës, nga 3000 euro, gjatë së cilës do të financohen projekte me më së shumti tri vende pune, përkatësisht deri në 9000 euro;
- Për veprimtaritë me volum më të madh të kredikërkesit, nga 5000 euro, ndërsa për hapjen e secilit vend të ri të punës nga 3000 euro, gjatë së cilës do të financohen projekte me më së shumti pesë vende, përkatësisht deri në 17.000 euro;
- Afati i kthimit të mjeteve është tri vjet duke përfshirë grejs periudhën prej një viti për kredinë deri 9000 euro, përkatësisht pesë vjet përfshirë grejs periudhën prej një viti për kredinë mbi 9000 euro;
- Baza e kamatës prej një për qind brenda një viti;
- Pjesëmarrje vetanake nga shfrytëzuesi i kredisë prej më së paku 25 për qind të shumës nga kredia e kërkuar (në formë të pajisjeve, gjërave materiale ose të parave);
- Garancia për kthimin e mjeteve me hipotekë në raport 1 : 1 me miratimin e kredisë, ose letrën e vet me vlerë të nënshkruar së paku nga një person për të cilën të drejtat dhe obligimet në raport me të janë përcaktuar me deklaratën e letrës me vlerë të dhënë në formën e aktit noterial dhe me klauzolë përmbaruese ose kapar në raport 1 : 2 në shumën e kredisë së lejuar;
- Mjete plotësuese stimulative deri 1000 euro për personat që janë: të papunësuar në bazë të tepricës teknologjike, falimentimit ose të likuidimit, dhe të cilët kanë marrë kompensim parash së paku gjashtë muaj, si dhe që janë të papunë më tepër se tri vjet.

Personat e papunësuar që janë të interesuar, kërkesën e kredisë mund ta dorëzojnë në klubet e punës së 30 qendrave të punësimit të Republikës së Maqedonisë, çdo ditë pune prej ora 09:00 deri më 14:00.

Informata më të hollësishme mund të merren në klubet e punës së 30 qendrave të punësimit të Republikës së Maqedonisë, në qendrën e kontaktimit 02/3111-850 dhe ueb faqen www.avrm.gov.mk

AGJENCIA E PUNËSIMIT
E REPUBLIKËS SË MAQEDONISË



Агенција за вработување на
Република Македонија

Agjencia e Punësimit e RM më 07.06.2018 shpall:

SHPALLJE PUBLIKE

Për të rinjtë e papunësuar të cilët duan të fillojnë biznesin e tyre nëpërmjet Projektit të vetëpunësimit me kreditim. Të drejtë për aplikim kanë të gjithë të rinjtë deri më 29 vjet të cilët janë të evidentuar si të papunë, pa marrë parasysh sa kohë ka qenë i pa punë, gjegjësisht persona të papunësuar që në mënyrë aktive kërkojnë punë, dhe që janë në evidencë një ditë para shpalljes publike.

Kushtet sipas të cilave mund të merren mjetet kreditore janë siç vijojnë:

- Për kredikërkesin 7 000 euro, ndërsa për hapjen e secilit vend të ri të punës 1 000 euro plotësuese të shumës bazë prej 3 000 euro, gjatë së cilës do të financohen projekte me më së shumti pesë vende pune, përkatësisht deri në 23.000 euro;
- Afati i kthimit të mjeteve është shtatë vjet (84 muaj), përkatësisht periudha e kthimit të mjeteve 66 muaj (5.5 vjet) dhe grejs periudhë prej 18 muajve (1.5 vjet);
- Baza e kamatës prej një për qind brenda një viti;
- Pjesëmarrje vetanake nga shfrytëzuesi i kredisë prej më së paku 25 për qind të shumës nga kredia e kërkuar (në formë të pajisjeve, gjërave materiale ose të parave);
- Garancia për kthimin e mjeteve me hipotekë në raport 1 : 1 me miratimin e kredisë, ose letrën e vet me vlerë të nënshkruar së paku nga një person për të cilën të drejtat dhe obligimet në raport me të janë përcaktuar me deklaratën e letrës me vlerë të dhënë në formën e aktit noterial dhe me klauzolë përmbaruese ose kapar në raport 1 : 2 në shumën e kredisë së lejuar.

Personat e papunësuar që janë të interesuar, kërkesën e kredisë mund ta dorëzojnë në klubet e punës së 30 qendrave të punësimit të Republikës së Maqedonisë, çdo ditë pune prej ora 09:00 deri më 14:00.

Informata më të hollësishme mund të merren në klubet e punës së 30 qendrave të punësimit të Republikës së Maqedonisë, në qendrën e kontaktimit 02/3111-850 dhe ueb faqen www.avrm.gov.mk

AGJENCIA E PUNËSIMIT
E REPUBLIKËS SË MAQEDONISË



Агенција за вработување на
Република Македонија

Agjencia e Punësimit e RM më 07.06.2018 shpall:

SHPALLJE PUBLIKE

Për hapje të reja vende pune për persona juridik (mikro dhe ndërmarrje të vogla) të cilat duan të zgjerojnë dhe zhvillojnë biznesin e tyre nëpërmjet shfrytëzimit të mjeteve kreditore

Fletëparaqitje mund të dorëzojë persona juridik (mikro dhe ndërmarrje të vogla) që është regjistruar së paku një vit, që ka së paku një të punësuar tre muaj para ditës së publikimit të kësaj shpalljeje publike, dhe që njëherësh nuk e ka zvogëluar numrin e të punësuarve në gjashtë muajt e fundit.

Fletëparaqitje për pjesëmarrje në këtë projekt mund të dorëzojë edhe personi i papunë që është evidentuar në Agjencinë e Punësimit të RM-së si person që në mënyrë aktive kërkon punë së paku një ditë para shpalljes publike, si dhe të mos ketë qenë në marrëdhënie pune së paku 3 muaj para shpalljes publike.

Kredia kap shumën prej 3000 euro për hapjen e një vendi të ri të punës me një shumë maksimale prej 9000 euro për hapjen e tri vendeve të reja të punës.

Në qoftë se punëdhënësi hap vende të reja pune për të rinjtë deri më 29 vjet, shumata e kreditit kap 4.000 euro për hapjen e një vendi të ri të punës me një shumë maksimale prej 12.000 euro për hapjen e tri vendeve të reja të punës për të rinj.

Personi juridik i cili do të punësojë një person të papunë me orar të plotë të punës, ka obligim që atë ta mbajë në punë së paku 36 muaj nga dita e themelimit të marrëdhënies së punës ose në vend të tij të punësojë me orar të plotë pune, ndonjë person tjetër të papunë nga evidenca e Agjencisë së Punësimit, përndryshe do të jetë i detyruar që para kohe ta kthejë kredinë në tërësi.

Kushtet sipas të cilave mund të merren mjetet kreditore janë siç vijojnë:

- Afati i kthimit të mjeteve është dy vjet.
- Grejs periudha prej një viti
- Kamata prej një për qind brenda vitit.

- Garancia për kthimin e mjeteve me hipotekë në raport 1 : 1 me miratimin e kredisë, ose letrën e vet me vlerë të nënshkruar së paku nga një person për të cilën të drejtat dhe obligimet në raport me të janë përcaktuar me deklaratën e letrës me vlerë të dhënë në formën e aktit noterial dhe me klauzolë përmbaruese ose kapar në raport 1 : 2 në shumën e kredisë së lejuar ose garancisë bankare.

Personi juridik gjatë paraqitjes është i obliguar që:

- të jetë i regjistruar së paku një vit deri në ditën e publikimit të shpalljes publike;
- në ditën e paraqitjes nuk është në procedurë falimentuese dhe likuiduese;
- t'i ketë paguar të gjitha tatimet dhe kontributet;
- të mos ketë punuar me humbje në vitin 2017.

Në qoftë se subjektet juridike, pas lidhjes me personat e papunë, të cilët kanë dorëzuar fletëparaqitje pas publikimit të shpalljes publike, nuk arrijnë që ta kënaqin nevojën e tyre me punëtor të profilit adekuat, atëherë Qendra e Punësimit do të angazhohet që të ndërmjetësojë për gjetjen e personave të papunë në evidencën e Agjencisë së Punësimit të RM-së.

Personat e interesuara juridike dhe personat e papunë, fletëparaqitjet mund t'i dorëzojnë në klubet e punës së 30 qendrave të punësimit në Republikën e Maqedonisë, çdo ditë pune prej ora 09:00 deri më 14:00.

Informata më të hollësishme mund të merren në klubet e punës së 30 qendrave të punësimit të Republikës së Maqedonisë, në qendrën e kontaktimit 02/3111-850 dhe në ueb faqen www.avrm.gov.mk.

AGJENCIA E PUNËSIMIT
E REPUBLIKËS SË MAQEDONISË

KËRKESA E KAMOTSHME QË NUK REALIZOHET

SEKTORI I BIZNESIT KËRKON TERMINAL NË JAZHINCË

Koha Urim HASIPI

Tetovë, 6 qershor - Sektori i biznesit vazhdon të kërkojë me ngulm hapjen e terminalit në Jazhincë. Kjo kërkesë është aktualizuar kohëve të fundit, kur pika kufitare në Jazhincë u rikthye në vendkalimin kryesor për automjetet e rënda të cilët nuk kanë transportuar materie të rrezikshme. Sipas Xhemali Dautit, ish kryetar i Odës Ekonomike të Maqedonisë Veri-Perëndimore, pronar i kompanisë Dauti Komerc, disa herë hapja e terminalit doganor në Jazhincë ka qenë temë e bisedimeve. "Me të gjithë kryetarët e komunave që gravitojnë në Pollog bashkë me Ddën nënshkruan një kërkesë tjetër që qeveria të fillojë të bëjë hapjen e këtij terminali doganor, nga ana e Kosovës kemi pasur kontakte të llojllojshme dhe ato kanë pasur gatishmëri kanë objekt dhe të bëhet edhe kufi i integruar, që domethënë pjesa teknike nuk ka problem", deklaroi Dauti. Ai më tej sqaroi se disa herë është shtruar si temë para autoriteteve qeveritare por konkretisht nuk ka asgjë. Këtë kërkesë ia ka adresuar edhe zëvendëskryeministrit Angjushev. "Problemi është tek vullneti i pushtetit në Maqedoni që ti hyjnë rrugës bile së paku nëse nuk mund të bëhet terminal doganor - të mundësohet lëvizja e mallrave përmes kufirit të Jazhincës edhe në ra-



Në rajonin e Pollogut shteti vazhdon që të mos përfill kërkesat reale të sektorit të biznesit dhe të Odës Ekonomike të Maqedonisë Perëndimore. Dy nga më shumë projektet jetike që kërkohen edhe nga ana e popullatës - siç është hapja e rrugës Tetovë-Prizren dhe terminali në Jazhincë, ende nuk janë në agjendën e Qeverisë

ste urgjente, por edhe në funksionimin normal të këtyre kompanive. Në takimin me zëvendëskryeministrit për çështje ekonomike, zotëri Angjushev këtu në UEJL para tre jave, premtoi dhe besojmë se së shpejti do të fillohet që të funksionojë edhe ai terminal", tha ai.

Me lëshimin në përdorim të rrugës Kaçanik-Hani i Elezit, tashmë është normalizuar edhe gjendja në vendkalimin kufitar në Jazhincë. Por në rajonin e Pollogut shteti vazhdon që të mos përfill kërkesat reale të sektorit të biznesit dhe të Odës Ekonomike të Maqedonisë Perëndimore. Dy nga më shumë projektet

jetike që kërkohen edhe nga ana e popullatës - siç është hapja e rrugës Tetovë-Prizren dhe terminali në Jazhincë, ende nuk janë në agjendën e qeverisë.

Kohë më parë, një ish kryetar tjetër i kësaj Ode ekonomike, Menderes Kuçi për gazetën Koha theksoi se hapja e terminalit do të ishte në interes të tregtarëve. "Përderisa një biznesi nga Tetova i duhen 20 minuta për të arritur në Jazhincë, ai duhet të bëjë 100 kilometra tjera dhe të pret radhë në Bllacë. Mund të thuhet se sa është i stimuluar ai, kurse zhargonit i politikanëve është të eksportojmë, e kështu me radhë,

por aty fshihet diçka tjetër. Kush të eksportojë, kompanitë e vet qeveritare, apo të atyre kompanive që e kanë arritur kapitalin në bazë të mundit të vet. Ne kemi sensibilizuar edhe faktorin politik që ti jepet përparësi hapjes së terminalit në Jazhincë, hapjen e rrugëve, ndryshimit të barrierave doganore, sidomos me tarifën që nuk janë të harmonizuara me këto dy shtete", tha Kuçi. Vlerësimet e njohësve të këtyre rrethanave janë se e për ndryshim të kësaj situatë nevojitet që faktori politik në vend, sidomos ai shqiptarë - të jetë më këmbëngulës në kërkesat dhe të jetë pjesë e vendimmarrjes për sa i përket aspektit ekonomik me qëllim që rajoni veriperëndimor të mos anashkalohet gjatë projekteve kapitale që janë në interes edhe të bizneseve, por edhe të popullatës.

Rritet numri i aksidenteve në Tetovë

Tetovë, 6 qershor - Asnjë viktimë dhe një person i lënduar rëndë janë pjesë e pasojave në gjithsej 77 aksidente trafiku që gjatë majit kanë ndodhur në rajonin e Tetovës, informojnë nga SPB Tetovë. Edhe pse numri i aksidenteve është për 10 raste më shumë në krahasim me të njëjtën periudhë vitin e kaluar atëherë ka pasur një viktimë dhe gjashtë të lënduar rëndë. Nga pasojat e tjera nga aksidente në muajin e kaluar të këtij viti, 26 persona kanë përfunduar me lëndime të lehta ndërsa në 43 aksidente janë shkakuar vetëm dëme materiale që gjithsej vlerësohet në mbi katër milionë e 600 mijë denarë. Më së shumti nga aksidentet ose 54, sërish kanë ndodhur në vendbanim para së gjithash në rrugët e Tetovës ku ka pasur 38 incidente të këtilla dhe drejt bulevardëve "Ilindenska", "Marshal Tito" dhe "Video Smilevski-Bato", pastaj rrugën rajonale Tetovë-Pirok me 17 aksidente, ndërsa në autostradën Gostivar-Tetovë-Shkup ka pasur 14 aksidente të këtilla.

Arsye më e shpeshtë për aksidentet edhe në muajin e kaluar ka qenë shpejtësia e papërshtatur gjegjësisht vëllimja e shpejtë me 17 raste, ndërsa menjëherë pastaj kryerje jo e rregullt e veprimtari si arsye për 15 incidente. Njëkohësisht, në muajin e kaluar në rajonin e Tetovës nga ana e policisë gjithsej janë kontrolluar 4.099 automjete me ç'rast janë zbuluar 1.329 lloje të ndryshme të kundërvajtjeve. Kundërvajtjet e zbuluara janë sanksionuar me 664 urdhëresa pagesore mandatare, 479 urdhëresa pagesore kundërvajtëse dhe me 168 paralajmërime me shkrim për shkelësit tregon statistika policore.

Ohri dhe Struga gati për turistët

Strugë, 6 qershor - Kapacitetet turistike në bregdetin e Ohrit dhe të Strugës janë plotësuar maksimalisht, ndërsa hotelierët presin sezon të suksesshëm turistik. Kryetari i Shoqatës së Hotelierëve të Maqedonisë - HOTAM, Kërste Bllazheski, konkludoi se pas tejkalimit të krizës politike dhe disa ngjarjeve të tjera që i kanë

shënuar viteve të fundit, është rritur interesi nga tur-operatorët dhe se kërkohet dhomë më shumë. Oferta turistike, sipas tij, është e pasur me ndërtimin e disa hoteleve të reja, si dhe renovimin e atyre ekzistues, që e rrit nivelin dhe cilësinë. Më tërheqës është destinacioni, siç theksoi, mbesim për holandezët, ndërsa

menjëherë pas tyre janë mysafirët nga Polonia, interes ka edhe në Belgjikë, ndërsa mysafirët e rivierës së Ohrit dhe të Strugës janë edhe turistët nga Izraeli, Turqia...si dhe nga vendet fqinje. Numri i turistëve nga vendet fqinje nuk është në nivel të lakmueshëm, ndërsa si shkak për vizitueshmërinë e dobët e theksoi

infrastruktura rrugore. Me ndërtimin e autostradës Kërçovë - Ohër pret rritje të numrit të mysafirëve nga Serbia. Nuk mungon as interesi për tureve atraktive, ku mysafirët qëndrojnë dy deri në tre ditë. Ata, sipas njeriut të parë të HOTAM-it, kontribuojnë për rritjen e numrit të bujtjeve në nivel vjetor.

DREJTORI I ESHS SHPALOS STRATEGJINË

Të gjithë do të regjistrohemi si "shtetas maqedonas"?

Shkup, 6 qershor - Regjistrimi i paralajmëruar i Popullsisë i cili planifikohet të realizohet gjatë vitit 2020, nuk duhet të përmbajë pyetje se cilës përkatësi etnike apo fetare i takojnë qytetarët. Kështu ka paralajmëruar Drejtori i Entit Shtetëror për Statistikë, Apostol Simovski, gjatë një interviste dhënë

1TV-së. Çështjet etnike, siç ka thënë Simovski, ishin arsyeja pse Regjistrimi i fundit që duhej të realizohej në vitin 2011 dështoi. "Vlerësoj se në Regjistrimin e popullsisë nuk duhet të përfshihet përkatësia etnike dhe fetare, të cilat nuk kërkohen as edhe sipas standardeve të Kombeve të Bashkuara. Regji-

strimi i popullsisë u kthye në një fushë-betejë të interesit të madh për politikën në vend. Regjistrimi i vitit 2011 dështoi pikërisht si rezultat i vënies gisht nga politika, kurse elementi i vetëm për të cilën është e interesuar politika është pikërisht përkatësia etnike. Kjo e dhënë nuk ka asnjë vlerë përveç asaj poli-

tike", është shprehur Simovski. Sipas drejtorit të Entit Shtetëror për Statistikë, që të hiqet politika nga vënia gisht në regjistrimin e popullsisë është që të hiqen pyetjet se cilës etni apo religion i takojnë qytetarët, pasi që çështja nuk ka të bëjë me përkatësinë etnike por me gjuhën që flasin qytetarët. Simov-

ski gjithashtu thotë se 18 vitet e kaluara pa realizim të një regjistrimi të mirëfillt të popullsisë e kanë lënë Maqedoninë pa mundësi për të marrë vendime të rëndësishme politike me qëllim përmirësimin e kushteve të jetesës dhe shmangies së gabimeve si rezultat i të dhënave të vjetra.

Ejjj, fëmijët janë shumë keq!

Nga
Nazim RASHIDI



Shpesh dëgjojmë, qoftë vetë, qoftë nga të tjerët apo qoftë nga politika se si i referohemi të ardhmes. E dëgjojmë frazën pa fund "punohet për të ardhmen". Apo "gjithçka bëjmë e lëmë trashëgimi për brezat që vijnë". Ose dhe fjali të tjera si "në emër të fëmijëve" e kështu më radhë. Por, e ardhmja, brezat, fëmijët e kanë punën shumë keq! Tmerr në fakt. Nuk është një fjali që e them për të përshkruar apo stilizuar një situatë, por është një realitet i tmerrshëm që më SHOKOI, besoj dhe juve.

Imagjioni, në Maqedoni më shumë se në vendet e tjera të rajonit përdoren metoda dhune për të disiplinuar fëmijët. Studimi që më ra dorë dhe që mu prezantua nga UNICEF-i në Shkup, thotë që gati dyfishi më shumë se vendet tjera të rajonit i të rriturve përdor elemente dhune ndaj fëmijëve dhe që kjo e dhënë të jetë edhe më shqetësuese, metodat e dhunës i përdorin edhe të rritur me të ardhura më të mëdha dhe ata me më vogla. Kjo gjë më bëri të shqetësohem shumë sepse tregon në fakt që bëhet fjalë për mendësi dhe jo një fenomen aksidental, klasor, rajonal apo etnik. Të dhënat thonë se 58.8 për qind e të rriturve me të ardhura më të vogla përdorin forma dhune ndaj fëmijëve. Më e përafërt me këtë shifër është Shqipëria, kurse në vendet e tjera si Mali i Zi, Bosnja, Kosova apo Serbia shifrat janë më të vogla.

Gati e njëjta pamje shfaqet edhe tek të rriturit me të ardhura më të mëdha mujore, 52.7 për qind e tyre në Maqedoni ushtrojnë forma dhune për disiplinë ndaj fëmijëve, kurse në rajon një lloj si më parë shifrat janë më të vogla po Shqipëria është më afër Maqedonisë me 39.9 për qind.

JU LUTEM MOS I LEXONI KËTO SHIFRA VEÇ SI ELEMENTE STATISTIKORE!

Sipas analizave të shumta dhuna dhe këto metoda sjelljeje nga të rriturit lënë pasojë të mëdha tek fëmijët, qoftë psikologjike qoftë edhe në zhvillimin e tyre dhe ajo e ardhmja për të cilën flasin të gjithë nuk do të jetë e ndritur.

Analiza që mu prezantua, kishte shumë elemente. Në opinion është bërë më shqetësuese fakti i vdekjeve të mëdha tek foshnjat. Me të drejtë, sepse Maqedonia ka 11.4 për qindjen e vdekshmërisë për 1000 lindje. Dramatikisht më e madhja në rajon dhe e vetmja që për pesë vjet ka rritje të numrit të vdekjeve tek foshnjat. Kjo



prirje është SHQETËSUESE, shumë madje, sepse në kohën kur fokus është tek politika, marrëdhëniet ndërretnike, në fakt rreziku më i madh për Maqedoninë nuk është asgjë tjetër veç mplakja e popullsisë dhe sidomos IKJA e saj nga vendi. Dhe si të rrinë njerëzit kur kushtet elementare për jetë dinjitoze nuk funksionojnë? Por, sa e tmerrshme është e gjitha kur këto konstatime përballen me shifrat që jo ALARM, po duhej të kishin ngritur të gjithë në këmbë.

Dhe kur kjo përputhet edhe me nivelet e varfërisë tek fëmijët, që është më e lartë se në BE, apo dhe

me nivelin e neglizhencës ose lënien anash të fëmijëve që sërish është më i larti së vendet e rajonit, sinqerisht shtrohen pyetjet e mëdha se ÇFARË BËJMË NE? ÇFARË BËJNË INSTITUCIONET? DHE ÇFARË BËJMË TË GJITHË SËBASHKU? Me atë që shoh nga shifrat e prezantuara, duket se fëmijët tanë po jetojnë në kushtet dhe mënyrat më të tmerrshme se gjithë të tjerët. Kjo do t'i lërë në dizavantash të tmerrshëm duke ua bërë "fat" dështimin apo dhe të qenurit më të prapambeturit se të tjerët.

Sërish dua ta theksoj, nuk është një tekst ky imi kësaj here që shpreh

Studimi që më ra dorë dhe që mu prezantua nga UNICEF-i në Shkup, thotë që gati dyfishi më shumë i të rriturve përdor elemente dhune ndaj fëmijëve dhe që kjo e dhënë të jetë edhe më shqetësuese, metodat e dhunës i përdorin edhe të rritur me të ardhura më të mëdha dhe ata me më vogla



më shumë emocione apo dhe pikëpamje rreth fenomeneve të caktuara. Është një shqetësim i ngritur deri në ULURIMË sepse sipas shifrave, neglizhenca fizike arrin gati 20 për qind tek fëmijët në Maqedoni, kurse ajo emocionale është më e lartë se sa tek vendet e tjera të rajonit dhe kap 30 për qind. Po si mund të rritet e të zhvillohet e ardhmja jonë, fëmijët tanë, ata që duhet të vazhdojnë atë që ne e lëmë, kur qenkan kaq të dhunuar dhe kaq të neglizhuar si emocionalisht, psiqikisht ashtu dhe fizikisht?

Seriozisht, studiuesit, psikologët dhe të gjithë që kanë mundësi ndikimi do të duhet të flasin pa fund për këtë fenomen që (mua të paktën) po na shokon kaq shumë.

Jemi rritur me idenë se prindërit janë të gatshëm të bëjnë çdo gjë për fëmijët. Në fakt të gjithë ne jemi dëshmitarë për sakrificat e mëdha që ata bëjnë që fëmijët të dali në jetë me dije dhe përgatitje për t'i bërë ballë asaj. Por, a është vërtet kështu? Shifrat e ushtrimit të dhunës dhe mostrajtitimit të fëmijëve na tradhtojnë. Diçka këtu duhet të ndryshojë DRAMATIKISHT! Pa diskutim që rol të madh duhet të marrë edhe shteti dhe shërbimet sociale. Por a do ta bëjnë këtë? Maqedonia si shumë

KOHA PËR KARIKATURËN E DITËS



Themelues: Arben Rattkoceri dhe Lirim Dullovi

Botues: Koha Production SHPK | Adresa e botuesit dhe redaksisë: Bul. Goce Delçev nr.11, | Q.T. Mavrovaska lok.14 - përdheshë, Shkup | Gazetë ditore - botohet çdo ditë përveç të dielës | Shtypi dhe distribuimi: "Adria Media Balkan" - rr. 852 nr.62, Shkup, 5000 Kocje | Data e shtypjes e mërkurë 6 qershor | Numri i parë i gazetës doli më 22 Nëntor 2006
Drejtor: Lirim DULLOVI | Kryeredaktor: Vedat MEMEDALIU | Redaktor përgjegjës: Emin AZEMI | Ndihmëskryeredaktor: Evis HALILI | Redaktor teknik: Halil BERISHA
E-mail: koha@koha.com.mk | Tel: 02 3179 - 904; Tel: 02 3179 - 905; Tel: 02 3179 - 906; Fax: 02 3118 - 060; | MARKETING: Bekim SHAQIRI • marketing@koha.com.mk; Tel: 02 3179-904; Mob: 071 372 222 | Përgjegjës për distribuim: Afrim DULLOVI - Tel: 071 372 221
Përfaqësues ligjor: Shtëpia e avokatëve Inter Partes - Shkup

NPK "Koha Production" Num. i xhironlogarisë: 210063340670177; Tutunska Banka -Shkup; Numri tatimor 4030008022772

vende të tjera të rajonit ka shumë probleme dhe vështirësi, por realisht, nuk duhet shumë, me gjithë vështirësitë, që të rregullohen disa gjëra elementare për fëmijët tanë.

Meqë kemi ministra të rinj, të arsimit dhe kulturës, minimalisht që ata duhet të bëjnë (dhe do të mbahen mend gjatë për sukseset) është të mundësojnë kushte elementare për ndjekjen e edukimit të tyre dhe zhvillimit kulturor. Ja edhe disa shifra të tjera të raportit përmbledhës nga UNICEF, ja edhe një alarm se si i lëmë fëmijët tanë të hendikepuar për jetë në raport me të tjerët. Maqedonia është një nga vendet që ka numrin më të madh e fëmijëve që nuk shkojnë në kopshte e çerdhe. Pra edukimi parashkollor, që është baza elementare për nxënien të mëtejshme nuk merret në një numër të madh. Duket diçka e thjeshtë? Epo jo. Fëmijët që kanë shkuar në institucione parashkollore, arrijnë rezultate më të mira në shkencë, matematikë apo dhe lexim se të tjerët.

ÇERDHE DHE KOPSHTË TË DETYRUARA!

Nëse edhe kjo e dhënë nuk mjafton të dhënat thonë se fëmijët tanë, janë tejet poshtë me rreth 34 për qind, në krahasim me vendet e zhvilluara që kapin deri mbi 90 për qind në rezultatet e zhvillimit bazik. Me fjalë të tjera fëmijët nga 0 deri në 5 vjeç krijojnë aftësi absorbimi, që nëse nuk u zhvillohen në institucione parashkollore, ata mbesin prapa. Dhe kur them prapa, jo vetëm botës por edhe atyre fëmijëve nga vendet e tyre duke krijuar një boshllëk që vështirë se plotësohet më tej në jetë.

Prandaj, në vend se arsim i mesëm i detyruar, të gjithë fëmijët tanë duhet të kenë çerdhe dhe kopshte të detyruara. Në vend se të flitet bosh për të ardhmen e brezave tanë, duhet minimalisht të krijohen kushte për art e kulturë duke mos lënë asnjë fëmijë pa mundësi zhvillimi të kreativitetit. Edhe një herë, pasojat janë për jetë, për ata dhe për të gjithë ne.

Do të lë profesionistët, të vazhdojnë ALARMIN me pasojat, por nuk mund ta përmbyll këtë tekst pa komentuar pamjet e skanimit të trurit të një fëmije të rritur pa dhunë, me kujdes dhe me kushte minimale mirëqenieje dhe jetese me ata të fëmijëve të abuzuar dhe pa mundësi zhvillimi. Pamja është se ne rrisim breza me gjysmë kapacitet dhe me pasoja të mëdha emocionale, intelektuale dhe fizike. Me gjithë këto shifra dhe studime (që në këtë tekst janë aq pak të përmendura dhe sipërfaqësore) realisht shtrohen dilemat: A vërtetë po punojmë të fëmijët tanë? Përgjigjen që besoj e dimë, duhet të fillojnë ta zbatojnë, si institucionet ashtu dhe ne vetë.

Ejj, fëmijët janë shumë keq, shumë. Por le të fillojmë me një përfaqim, një përfaqim më shumë!

(Autori është kolumnist i rregullt i gazetës KOHA)

ERGA OMNES

Muajve të fundit në fjalorin politik shprehja më e pranishme në Maqedoni ishte togfjalëshi "Erga Omnes". Kjo shprehje u identifikua aq shumë me zgjidhjen e problemit të emrit, dhe kryeministrat e dy vendeve, sa që dikush mbase mund edhe të mendonte se njëri nga dy këto kryeministra, quhej Erga, ndërsa tjetri Omnes. U desh shumë kohë që populli, madje edhe klasa politike këtu në Maqedoni, ta kuptojë domethënien e saj, disa nga të cilët ende nuk janë në gjendje ta shqiptojnë si duhet. Disa nga maqedonasit dinë vetëm se për Maqedoninë është diçka e keqe e cila mund t'i prek edhe në gjuhë e identitet, që bashkë me emrin, mezi i kompletuan, gjatë historisë, që nga viti 1944, kur u bënë pjesë e Jugosllavisë e deri në kohën e pavarësisht, në vitin 1991, kur emrin e shtetit të përbashkët me shqiptarët dhe të tjerët, por jo edhe të barabartë për të gjithë, e humbën sërish, për t'u njohur ndërkombëtarisht si IRJM.

Emri i ri i shtetit, që u pavarësua tërësisht nga Jugosllavia që po shpërbëhej, realisht nuk ishte emër, por vetëm lojë fjalësh diplomatike nën presionin e fuqishëm të Greqisë, që e vuloste fatin e një shteti që nuk ekzistonte më me atë emër, dhe pikërisht për këtë edhe u konsiderua si i përkohshëm. Ky ishte një realiteti i hidhur për maqedonasit dhe elitat e tyre politike që në atë kohë, prandaj tani, pas aq shumë vitesh, formula ERGA OMNES (për përdorim të përgjithshëm), që vjen nga ana e negociatorëve grekë, nuk ka pse të jetë aq befusuese për një pjesë të maqedonasve të cilët edhe me

emrin e përkohshëm, madje jashtë integriteteve në NATO e BE, shteti të cilin e llogarisin vetëm të vetin, as që mund të mbijetojë.

Edhe shqiptarët nuk do ishin për ndërrimin e emrit të shtetit në të cilin fati historik i detyroi të jetojnë me maqedonasit dhe të tjerët, nëse kjo nuk do ishte domosdoshmëri për shkaqe tani më të njohura. Historikisht dihet se shqiptarët i lidh shumëçka me maqedonasit e vjetër dhe Lekën, emrin e të cilit Shqipëria prej kohësh e ka edhe emër të monedhës kombëtare, prandaj nëse i dhimbset dikujt emri Maqedoni, pa ndonjë referencë, qoftë gjeografike apo kohore, ato duhet të jenë shqiptarët. Me gjithë këtë realitet historik, jemi të vetëdijshëm ne shqiptarët për sikletin që kanë maqedonasit, të cilët janë të lidhur emotivisht me emrin Maqedoni, territor ky nga i cili edhe u emërtuan si komb.

Shqiptarët, nga bashkëjetesa e imponuar një kohë të gjatë me sllavët, qysh në periudhën e Mbretërisë së SKS-së, në atë të "Vëllazërim-bashkimit" të Titos dhe në shtetin e pavarur, që mbeti pa emër të njohur nga OKB dhe shumë shtete të botës, kanë vetëm kujtime të hidhura. Gjatë dhjetëvjetëshit të fundit të periudhës komuniste, shqiptarët u akuzuan vazhdimisht për irredentizëm, fjalë kjo që për shumëkënd as që dihej se çka donte të thotë, përveç se një fjalë e keqe që të çonte në burg. Për 10 vite me radhë, që nga 81-shi, kjo fjalë që peshon rëndë në kujtesën e shqiptarëve, sidomos të atyre të Maqedonisë, i dërgonte në burg qindra e qindra "irredentistë e nacionalistë", që kinse paskan dashur

një pjesë të Maqedonisë t'ia bashkangjesin Shqipërisë.

Në brendinë e kësaj fjale qëndronte tmerri i vërtetë, ajo ishte damka e zezë që ta merrte lirinë pa asnjëfarë prove gjyqësore. Populli thotë: "Ra kjo vdekje e u pamë." Brenda kësaj thënieje sa filozofike aq edhe kanunore, qëndron një e vërtetë e madhe. Rasti i kontestit të emrit kushtetues të Maqedonisë, por të panjohur ndërkombëtarisht, përveç tjerash, nxori në dritë edhe apetitet romantike të disa qarqeve politike maqedonase, që kryeqytetin e Maqedonisë do e zhvendosnin nga Shkupi në Selanik, që nga pala greke, bashkë me këmbënguljen për mosndërrimin e emrit, konsiderohej si irredentizëm.

Kjo histori me dyshimet për irredentizëm ndaj Greqisë u riaktualizua në momentin kur Kryeministri Zaev e propozoi emrin e ri, të mundshëm "Republika e Maqedonisë së lindenit", emër ky që në heshtje u pranua edhe nga VMRO, por që ky pajtim nuk zgjati shumë, meqë pala greke shumë shpejt e hodhi poshtë, edhe pse ajo maqedonase u pajtua që ky emër t'i nënshtrohet ERGA OMNE-es. Po e mbyll këtë shkrim edhe me dy thënie tjera popullore: "Çka ka n'kojshi, prite n'shpi", që për rastin konkret do i përgjigjej kjo fjalë: "Ate çka ke bë te shpia, tani ta bën kojshia". ERGA OMNES, shprehje kjo e pa njohur në skenën politike, në kohën kur shqiptarëve të Maqedonisë ju nëpërkëmbeshin të gjitha të drejtat, sot u kthehet bumerang bashkështetasve tanë maqedonas. Jo më kot një thënie tjetër e urtë thotë: "Çka bajsh, ta bajn dhe një ta shtojnë".



Nga
Vebi BEXHETI

Po e mbyll këtë shkrim edhe me dy thënie tjera popullore: "Çka ka n'kojshi, prite n'shpi", që për rastin konkret do i përgjigjej kjo fjalë: "Ate çka ke bë te shpia, tani ta bën kojshia". ERGA OMNES, shprehje kjo e pa njohur në skenën politike, në kohën kur shqiptarëve të Maqedonisë ju nëpërkëmbeshin të gjitha të drejtat, sot u kthehet bumerang bashkështetasve tanë maqedonas. Jo më kot një thënie tjetër e urtë thotë: "Çka bajsh, ta bajn dhe një ta shtojnë"



XHEVDET NASUFI, JURIST DHE POLITIKAN

KOMPROMISET SHQIPTARE NË DËM TË VETVETES

Edhe te shqiptarët pluralizmi politik është zhvillim që nuk është ndarë nga e kaluara, krahas të sotmes që vazhdon. Që ironia të jetë befasuese, fenomeni i të kapurit të shtetit ndër shqiptarët në Kosovë dhe Maqedoni po ndodh prej forcave të UÇK-së nëpërmjet formimit dhe organizimit politikë të tyre. Në të dy vendet, kryetarët e partive respektive kanë qenë edhe prijësit e luftës e sot e kanë shtetin në posedim...



Koha Delvina KËRLUKU

Xhevdet Nasufi ka lindur në vitin 1948 në Veleshtë, ku edhe ka mbaruar tetëvjeçaren. Gjimnazin në qytetin e Strugës, aty ku për të parën herë u bë pjesë e revoltës kolektive kundër pushtetit antishqiptar që denigronte profesorin shqiptar.

Në vitin e demonstratave studentore të 1968-ës, në Prishtinë, për të dytën herë u bë pjesë e revoltës kolektive antisistem, si student i Fakultetit Juridik, kur edhe filloi me punë si gazetar në gazetën e studentëve BOTA ERE. Paralelisht, në shoqërinë akademike "Ramiz Sadiku" Xhevdetin e pranuan në grupin e aktrimit. Pas mbarimit të studimeve dhe punës së shkurtër në RILINDJE, u punësua në Shkup si gazetar në "FLAKËN E VËLLAZËRIMIT". Pas një kohe u kthye përsëri në Prishtinë, tani më si udhëheqës në Mihjen sipërfaqësore të Bellaqevcit në kuadër të Kombinatit të Obilikut.

Vazhdoi studimet pasuniversitare në Universitetin e Zagrebit në vitin 1973, ku edhe fitoi titullin magjistër. Doktoroi në Shkup. Në vitin 1975 u burgos me grupin e Adem Demaçit,

ndërsa dënimin e vuajti në burgun famëkeq të Goli Otokut. Pas lirim, një kohë punon në Vushtrri të Kosovës, ku edhe krijon familjen. Pas informatave se kërkohet nga regjimi i Milloosheviqit, në vitin 1992, largohet drejt Veleshtës së Strugës, ku fillon biznes familjar.

Ka qenë deputet dhe ministër i Drejtësisë nga radhët e Partisë Demokratike Shqiptare.

KOHA:Keni qenë gazetar,drejtor, ministër, deputet,pedagog universitar, pronar kompanie relativisht të suksesshme. Në kostumin e të cilit jeni ndjerë më komod dhe pse?

NASUFI: Është e mbrapsht praktika që funksionarët në politikë ndihen të pa sikletshëm në funksionet e tyre. Pra, logjika është e qartë, do duhej të ndihesh më i pa rehatshëm, më i akomoduar si ministër e deputet. Askush nga politikanët nuk ka vuajtur për mosdijen, për mos konsekuencën, për abuzim me ligjin, me pasurinë, bile as për mos impenjim në ndërtimin e barazisë së shqiptarëve me Maqedonasit. Kjo reflekton shpërputhje të skajshme të politik bërësve shqiptar nga tendencat në rritje dhe të natyrshme të na-

cionalizmit në botë. Tendenca jonë shkon ka përafrimi me ideologjinë e vëllazërim-bashkimit ireal në relacion me sllavët. Mendojse këtu është edhe arsyeja pse çështja shqiptare në Maqedoni, fare ngadalë lëviz nga pozicioni i ankoruar. Argument i fuqishëm për këtë është fakti që shqiptarët lehtë i bëjnë kompromiset joparimore me sllavët në dëm të vetvetes, duken të pafuqishme në përballje me agresivitetin sllav, grekë etj. Konkretisht, derisa shqiptarët në bisedën politikë mjet kanë bontonin politikë dhe fjalorin ezopian, sllavët përdorin agresivitetin dhe gënjeshtëri. Imagjinoni të ishin shqiptar vandalët e 27 prillit 2017 në Kuvendin e Maqedonisë?! O tempora o mores! Dhe në të njëjtin rrafsh, si do e shpjegojmë faktin që edhe pas luftërave në territorin e ish Jugosllavisë pothuajse të gjithë e zgjidhen shtetësinë në rrafshin etnik (sllavenët, kroatët, maqedonët, malazezët, bosnjakët) përveç shqiptarëve, që edhe në numër ishin të tretët në vend. Bëra këtë hyrje, sepse zhvillimet respektive në Maqedoni janë të tilla që më së pakti intelektualëve,veprimtarëve publik,e politik bërësve në veçanti, nuk u japin të drejtën

për komoditet.

Përndryshe, gjithmonë komoditeti nuk ka munguar te unë, ama kur gjithçka që kam kryer ka arritur objektivin. Ka qenë e veçantë nata e parë kur me Kryeministrin e vendit dhe grup ministra në orë e vona të mesnatës nga veranda e qeverisë shikonim bashkërisht me admirim filmin bombardimet e NATO-s mbi qiellin e Maqedonisë të nisur për të sulmuar caqet e Milloshëviqit. Ishte kjo kënaqësi për komoditet përallor, sepse Kosovës i buzëqeshte pavarësia, shtetësia e endërruar shekullore, në të cilën bashkë me shumë të tjerë lash një gjurmë edhe unë.

KOHA:Si kuadër i PDSH-së keni bashkëpunuar me kryetarin Arben Xhaferi. Vlerësimi për të është i konsiderueshëm edhe sot e gjithë ditën. Sipas jush, ku mbështet kjo konsideratë?

NASUFI: Kuptueshëm, si lider partie Arben Xhaferi ishte arsyeja që si anëtar i grupit të të burgosurve politikë në vitin 1975 në Prishtinë (grupin e përbënin diku rreth 45 veta të udhëhequr nga Adem Demaçi, nga Maqedonia edhe Zudi Bilali) të bëhem anëtar i qeverisë së Repu-

blikës së Maqedonisë. Fillimisht në postin e Ministrit për pushtetin vendor. Pas kësaj, gjatë rikompozimit të parë të qeverisë mu dha të udhëheq Ministrin e Drejtësisë që ishte një sinjal ugur-bardhë për shqiptarët. E them këtë sepse, përveçse nuk lejova në Maqedoni dikush të inskenoj, sajoj dhe përgatis skenarë morbide nëpërmjet gjyqësorit. Sfiduam edhe dy luftëra, Kosovë e Maqedoni duke mos shënuar asnjë incident, kundër edhe një Shqiptari të vetëm. Përkundër, janë shpërfillë dogmat juridike në të mirë të shqiptarëve gjithmonë kur ka qenë e mundshme. I këtuillë ishte rasti edhe i mos ekstradimit të Fazli Veliut (asnjëherë s'ka qenë mirënjohës për këtë), Xhavit Hasanit e shumë të tjerë. Dhe në fundin e mandatit të qeverisë, menaxhova dikasterin përgjegjës për zbatimin e Marrëveshjes Kornizë të Ohrit, zëvendës kryeministër. Kjo, për pak kohë që nuk më mundësoi të zbatojë programin operativ timin për zbatimin e MO-së, i cili program jo që nuk pa dritën e bardhë, por edhe MO u sakatua në shumë segmente. Qeveria PDSH-VMRO (1998-2002) menaxhoi dy momente historike: Luftën e Kosovës dhe atë të shqiptarëve në Maqedoni. Kosovarëve, Maqedoninë ja u shtruan sofër. Në front, UÇK-së i afroam veç mendësisë intelektuale dhe logjistikën e nevojshme, gjithçka që duhej dhe kërkuan. Lufta e Kosovës ishte dhimbje dhe krenari e jona, e imja në veçanti. Imagjinoni, një i persekutuar si unë në Kosovë dhe për Kosovën të gjendet në pozitën dhe rolin kur i shërben kauzës të vet nga pozicioni i rëndësishëm shtetëror.

Luftën e vitit 2001 në Maqedoni e menaxhuam politikisht në mënyrën më të mirë të mundshme pa të voglin lëshim. Fillim vlerësimet për UÇK-në si grup terrorist, shpejt nën elaborimet e fuqishme të PDSH-së u konvertuan dhe u legjitimuan në tavolinën e bisedimeve politike që i udhëhoqi PDSH, në Ohër.

Në fakt, Marrëveshja e Ohrit i konkretizoi dhe përligjësoi edhe ndryshimet e nisura nga qeveria PDSH-VMRO (1998 - 2002), si moment gjegjës por, mjerisht, këto praktika të mbara nuk u avancuan nga qeverisjet e mëvonshme sot e kësaj dite. Bile, ka reduktime, tkurrje, padrejtësi përball tyre. Vetëm një shembull: Shikoni sot Ministrin e Drejtësisë dhe të Ekonomisë, të zhveshur tërësisht nga shumë funksione, krahasuar me vitet 1998 - 2002.

Në këto suksese la gjurmë të shkëlqyera PDSH-ja dhe Arbeni, për konsideratë.

KOHA: Sa ishit ministër i Drejtësisë, keni patur një rast tejet delikat, por keni arritur ta menaxhoni mirë. Fjala është për kërkuesin për ekstradim të Fazli Veliut. Na flitni pak më tepër për këtë rast dhe si ia arritët që të mos e ekstradoni z. Veliu?

NASUFI: Ndoshta edhe nuk do ishte aq afirmative ti kthehem kësaj historie, por zhvillimet dhe peripecitë që sfidoi dhe që kolateroi për të keq edhe në biznesin tim, si individ dhe si familje. E pabesueshme, pikë-

FMN-ja KUNDËR KOMPENSIMIT TË MËSIMDHËNËSVE TË VITEVE TË '90-ta

Një mision i Fondit Monetar Ndërkombëtar (FMN) ka përmbyllur vizitën në Kosovë të zhvilluar nga 30 maji deri më 5 qershor.

Gjatë qëndrimit në Kosovë, ky mision në fokus të agjendës së tij ka pasur zhvillimet e fundit ekonomike dhe perspektivën ekonomike të Kosovës.

Sipas një deklarate të lëshuar për medie, FMN-ja pret që rritja ekonomike për këtë vit të jetë në nivelin 4 për qind, derisa sektorin bankar e ka vlerësuar si të mirëkapitalizuar, likuid dhe me përfitime.

Më tutje, misioni i FMN-së ka këshilluar institucionet e Kosovës që të refuzohet Projektligji për kompensimin e mësuesve të viteve të '90-ta.

"Misioni këshilloi të mos vazh-



dojnë përpara me projektligjin aktual të kompensimit të mësuesve, për shkak të kostove të mëdha fiskale direkte dhe indirekte, të cilat do të rëndojnë buxhetin për shumë vite dhe do t'i zënë vendin shpenzimeve të tjera prioritare", është thënë në deklaratën e FMN-së.

Sa i takon reformave për veteranët e luftës së UÇK-së, FMN-ja ka

kërkuar avancimin e këtyre reformave, por ka theksuar se nuk duhet të prezantohen programe të reja me përfitime shoqërore.

"Qeveria e Kosovës duhet të ketë kujdes edhe me ristrukturimin e sektorit publik, për të minimizuar rreziqet. Misioni këshilloi që reforma në administratën publike të hartohet mbi bazën e

ligjit për kufizimin e pagave. Sa i takon sektorit privat, reformat strukturore mbështetëse duhet të përshpejtohen për të arritur një rritje më të fortë dhe të qëndrueshme ekonomike, të redukojë hendekun e pagave me pjesën tjetër të Evropës dhe të adresojë papunësinë e lartë", është thënë në këtë deklaratë.

Kurti: Bashkimi i Mitrovicës më i rëndësishëm se ulësja në OKB



Lideri i Lëvizjes Vetëvendosje, Albin Kurti, ka zhvilluar një takim me raportuesin e Bashkimit Evropian për Kosovën, Igor Soltes. Gjatë takimit është bise-

duar për situatën politike dhe institucionale në Kosovë, për drejtësinë dhe EULEX-in, e po ashtu për dimensionin social e ekonomik të vendit.

Kurti gjatë takimit theksoi se "për shtetndërtimin dhe zhvillimin tonë bashkimi i Mitrovicës është më i rëndësishëm sesa ulësja në OKB që po premtohet pa mbulesë dhe se tash kur shënojmë një dekadë të EULEX-it mund të themi se ai ka dështuar sa i përket si krimeve të luftës po ashtu edhe krimeve të paqes".

Ky takim, siç thotë partia, ishte në kuadër të një bashkëpunimi të vazhdueshëm të Lëvizjes Vetëvendosje me përfaqësuesit dhe zyrtarët nga Bashkimi Evropian.

Marrëveshja e demarkacionit Kosovë-Mali i Zi, në fuqi nga 4 qershori

Marrëveshja e demarkacionit mes Kosovës dhe Malit të Zi ka hyrë në fuqi më 4 qershor, bën të ditur Ministria e Punëve të Jashtme e Malit të Zi. Ambasadori i Republikës së Kosovës në Mal të Zi, Skënder Durmishi, i dorëzoi drejtoreshës për çështje ligjore ndërkombëtare, Tatjana Raspopoviç, notën verbale të Ministrisë së Punëve të Jashtme të Kosovës me anë të së cilës "pala malazeze njoftohet se Kosova ka përfunduar procedurat e brendshme ligjore të nevojshme për hyrjen në fuqi të Marrëveshjes Kufitare Shtetërore midis dy vendeve, nënshkruar në Vjenë më 26 gusht 2015", njofton Radio Televizioni i Malit të Zi, RTCG. Marrëveshja për Demarkacionin në Kosovë u miratua në fund të muajit mars të këtij viti, pas tri vitesh zvarritje e mos pajtime në spektrin politik. Ndërsa Mali i Zi e kishte ratifikuar marrëveshjen në fund të dhjetorit 2015. /KosovaPress



Dronët misterioz sollën ushtrinë serbe në kufi me Kosovën

Në muajin mars disa dron misterioz 'fluturuan' mbi Serbi. Deri tani, shteti serb nuk ka pasur ndonjë informacion lidhur me këtë çështje. Mirëpo ministri i brendshëm serb, Nebojsa Stefanoviq, ka qenë i detyruar të flas para Parlamentit serb lidhur me këtë çështje. Ai kishte deklaruar se kishte informacione për fluturimin e dronëve misterioz mbi Serbi por sipas tij, ato nuk përbënin ndonjë kërcënim për sigurinë e vendit. Por, beogradasja Sputnik ka marrë një përgjigje nga Ministria e Mbrojtjes së fundmi. Në përgjigjen e kësaj ministrie, është thënë se 'kata dron mund të kenë qenë të lidhur me aktivitete ilegale, transferim të migrantëve nga grupet e organizuara kriminale, transportim të narkotikëve ose aktivitete tjera të natyrave ilegale'. Gjithashtu është konfirmuar se njësitet e ushtrisë serbe, kanë zbarkuar në kufi me Kosovën, duke regjistruar disa tendenca për hyrjen e dronëve të vegjël, të cilët, sipas mediave serbe, është tentuar të sjellen brenda Serbisë. Ministria ka thënë se ushtria nuk ka reaguar sepse 'ekzistojnë procedura strikte në rast të cënimit të sovranitetit të shtetit', transmeton Periskopi. "Ne kemi analizuar të gjitha rrethanat e fluturimit të këtyre dronëve në vendin tonë por kemi ardhë në përfundim, në bazë të analizave të kryera, se ata nuk kanë paraqitur ndonjë rrezik për qytetarët e Serbisë", është thënë në përgjigjen e Ministrisë së Mbrojtjes.

GREQIA MBAN TË "BURGOSUR" MIJËRA PENSIONISTË SHQIPTARË

Një problem mes shumë problemeve të tjera të emigrantëve tanë, që askush nuk dëshiron ta prekë sado pak për të nxjerrë në sipërfaqe këtë padrejtësi që u bëhet bashkatdhetarëve tanë. Bëhet fjalë për mijëra pensionistë shqiptarë që në mënyrë arbitrare mbahen të burgosur brenda territorit grek, duke mos pasur të drejtë që prej më se 15 vitesh të shkojnë në atdheun e tyre. Janë ligjet absurde këto që i mban të burgosur këta shqiptarë të moshuar, kur dikur ishin të aftë për punë dhe që me djersën e tyre kontribuan në ndërtim dhe ngritjen ekonomike të Greqisë. Janë ish-kuadro të



rëndësishëm si ushtarakë, diplomatë, agronomë, artistë dhe punëtorë krahu apo gratë heroina që flasin për këtë padrejtësi që u bëhet nga një vend i BE-së.

Padrejtësia ka nisur 15 vite më parë ku autoritetet vendore greke u merrnin lejet e qëndrimit emigrantëve shqiptarë që mbushnin moshën 70 vjeç duke i detyruar ata

nga ish-emigrantë të legalizuar në atë klandestinë. Të dëshpëruar por me kokën lart këta disa herë kanë ngritur problemin në të shkuarën pranë Ambasadës sonë në Athinë, por deri më sot, këta qëndrojnë klandestinë në vendin ku punuan dhe jetuan prej shumë vitesh. Sikur të mos mijaftojë mosnjohja e punës së tyre në vite për pension të pjesëshëm, këta po ndeshen edhe me burgosjen e tyre në Greqi. Shteti shqiptar duhet të ndërhyjë për të zgjidhur këtë padrejtësi që u bëhet shtetasve të tij, nëse e do këtë komunitet ashtu siç duhet të dojë e t'i mbrojë secili shtet shtetasit e tij kudo që ndodhen. /Gazeta Telegraf

SI DO E SHKATËRROJNË POPULISËT ITALINË DHE BE?

Në Bashkimin Evropian ende pa u kapërcyer mirë kriza e Greqisë, po afrohet kriza tjetër, më serioze për eurozonën. Ekonomikisht Italia është dhjetë herë më e madhe se fqinji i vogël në jug. Nëse Roma do të ecte drejt një falimentimi shtetëror, kolapsi në tregun financiar mund të merrte me vetë për poshtë të gjithë monedhën e përbashkët



Do të ishte çudi po të mos rezultojë kryeministri i ri një marionetë në duart e dy kryetarëve të partive Lega dhe Lëvizjes Pesë-Yjet. Sepse profesori i panjohur i lëndëve juridike nuk ka rrënjë as te Lega, as te Pesë-Yjet, pushtetin ai e ka vetëm të marrë hua. Giuseppe Conte është destinuar që të jetë një figurë e dobët – një kryeministër, të cilit i duhet të telefonojë më parë në dy qendra të partive, përpara se t'u premtojë gjë kolegëve Merkel dhe Macron.

Kjo qeveri përbëhet nga fillestarë – me përjashtim të ministrit të ri të Jashtëm. Kjo i jep asaj në sytë e zgjedhësve edhe më shumë besueshmëri, sepse bën pjesë në standardet e populistëve, që të shajnë e mallkojnë të ashtuquajturat establismente.

Programi i kësaj martese midis dy partive krejt të papajtueshme ideologjikisht me njëra-tjetrën, konsiston para së gjithash në dhurata të papagueshme për zgjedhësit. Dhe ata janë kaq të etur për

ndryshime, për njerëz të rinj në politikë, sa kanë harruar se si bëhet llogari. Sepse taksa e sheshtë, me të cilën do t'i lumturojë mbështetësit e tij udhëheqësi i Lega-s Matteo Salvini do t'i kushtojë shtetit miliardë dhe do të sjellë fitime vetëm për të ardhura që prej 30.000 euro. Por njerëzit me të ardhura të pakta, ata të cilët votuan në radhë të parë për populistët, do të jenë në një pozitë më të keqe se më parë.

NJË ENDËRR E KEQE PËR EVROPËN

Ndërsa e ardhura bazë, të cilën ia ka premtuar Lëvizja Pesë Yje jugut të varfër, në fakt zëvendëson sigurimin social, që mungon prej dekadash në Itali. Për fat të keq shteti për këtë nuk i ka aktualisht paratë dhe vrimat gjigande, të cilat do t'i japin në buxhet të dyja projektet, nuk mbushen duke marrë vetëm ca borxhe.

Në përgjithësi ideja bazë ekonomike e kësaj qeverie është shumë e diskutueshme: që Italia do të dalë

nga borxhet, duke shpenzuar më shumë para. Janë një grusht ekspertësh që përfaqësojnë pikërisht këtë doktrinë. Por meqenëse Donald Trumpi po e çon aktualisht në humnerë koniunkturën globale, nuk mund të parashikosh se si do t'i shpëtojë Italia kësaj vorbulle thithëse negative.

Në Bashkimin Evropian ende pa u kapërcyer mirë kriza e Greqisë, po afrohet kriza tjetër, më serioze për eurozonën. Ekonomikisht Italia është dhjetë herë më e madhe se fqinji i vogël në jug. Nëse Roma do të ecte drejt një falimentimi shtetëror, kolapsi në tregun financiar mund të merrte me vetë për poshtë të gjithë monedhën e përbashkët.

Ende nuk dihet se sa nga premtimet e pafinancueshme do të zbatohen në rinjtë në Itali. Por gjithsesi Brukseli ka para vetes kohë të paqeta, sepse qeveria Conte do të kërkojë leje për të hyrë në borxhe pa u shqetësuar. Por këtë leje BE nuk mund t'ia japë, përplasja është e programuar.

SI DUHET TË QENDROJË NË KËMBË KY KOALICION?

Edhe përtej kësaj, nuk do të ketë gjë tjetër veçse grindjes me këta italianë. Shprehjet e shefit të Legas, Salvini për ndarjen racore në tramvaje tregojnë mendësinë e tij ekstremiste të djathtë, raciste. Nëse si ministër i Brendshëm ai do t'i çojë emigrantët në kampe, në Itali do të shpërthejë një luftë e ashpër për të drejtat e njeriut. Edhe një gjë: populistët në Romë u mbushin mendjen njerëzve se fajin për krizën e Italisë e ka Gjermania.

Ky është një budallallëk dashakeq. Mesatarja statistikore e mirëqënies për frymë në Itali është më e lartë se në Gjermani. Por fqinjët kanë një problem të madh të shpërndarjes. Shikoni veten tuaj, të dashur italianë, dhe mos ua hidhni të tjerëve kaosin, korrupsionin, punët shkel e shko, zhvatjet dhe të tjerat që e paralizojnë këtë vend të bukur. Dhe pavarësisht nga kjo ajo që ka rëndësi: Avanti dilettanti!

(Deutsche Welle)

Katër vende, gati t'i bashkohen NATO-s

Vendet anëtare të Aleancës së Atlantikut Verior përballen me sfida të sigurisë ndërsa përgatiten për takimin e muajit korrik në Bruksel. Mes sfidave madhore për vendet e NATO-s janë rritja e tensioneve me Rusinë, e cila prej kohësh ka kundërshtuar zgjerimin e aleancës në Evropën Lindore. Para takimit të 11 korrikut, katër vende kanë deklaruar synimet e tyre për t'u anëtarësuar në aleancë. Këtu përfshihet zgjerimi me vende të reja për forcuar aleancën. Ish-senatorja Kay Bailey Hutchinson është Përfaqësuese e Përhershme e Uashingtonit në NATO. "Jemi atje për të përcaktuar standardet dhe që t'i ndihmojmë t'i plotësojnë ato. Kjo është politika e dyerve të hapura, një politikë dinamike." Një politikë e tillë mund të shërbejë si baraspeshë ndaj rritjes së influencës ruse në Ballkan, thotë ish-zëvendës shefi i NATO-s Alexander Vershbow. Greqia kundërshton emrin e atij vendi duke thënë se përbën pretendim territorial të rajonit verior grek me të njëjtin emër. Përfshirja e Perëndimit në çështjen e emrit mund të lehtësojë anëtarësimin e Maqedonisë në NATO, por vetëm nëse Shkupi përmbushë kërkesat strikte të Aleancës. Sarah Macintosh është ambasadore e Britanisë në NATO. "Vendet e Ballkanit Perëndimor që duan të anëtarësohen në NATO, duhet të plotësojnë standardet dhe kriteret që kërkohen dhe pastaj do të anëtarësohen." NATO ka përditësuar faqen e saj në internet duke përfshirë katër vendet që kanë shprehur synimet për anëtarësim. Ato janë Ukraina, Bosnje-Hercegovina, Gjeorgjia dhe Maqedonia. Mes kërkesave për anëtarësim, është edhe zotimi për të shpenzuar të paktën 2 për qind të prodhimit të brendshëm për mbrojtjen, një angazhim që aktualisht e përmbushin vetëm pesë vende, ndër to Shtetet e Bashkuara.

Takimi Trump-Kim Jong në një hotel luksoz

Takimi i shumëpritur në mes të presidentit amerikan, Donald Trump dhe liderit verikorean, Kim Jong-un, do të zhvillohet në një hotel në ishullin Sentosa të Singaporit, ka njoftuar Shtëpia e Bardhë. Samiti historik është planifikuar të mbahet më 12 qershor, mirëpo detajet tjera mbesin ende të pakonfirmuara. Ky njëherësh do të jetë takimi i parë i ndonjë lideri verikorean me një president amerikan në detyrë. Trump ka thënë të martën se planet "janë duke shkuar shumë mirë". "Shumë marrëdhënie janë duke u krijuar, shumë negociata janë duke u bërë përpara takimit", u



ka thënë ai gazetarëve. "Është takim shumë i rëndësishëm, do të jenë disa ditë tejet të rëndësi-

shme". Sekretarja e Shtëpisë së Bardhë, Sarah Sanders, ka konfirmuar përmes një postimi në

Twitter, se samiti do të zhvillohet në Hotelin luksoz, Capella. Hotel Capella është një hotel me pesë

yje në ishullin Sentosa, i cili ka disa vendpushime, hotele, dy fusha golfi dhe një park. Hoteli, i projektuar nga arkitekti i njohur britanik Norman Foster, ka 111 dhoma dhe një rezidencë presidenciale, të shpërndarë në mbi 12ha tokë. Siguria ishte një shqetësim kryesor për koreano-veriorët gjatë diskutimeve, thanë burimet për CNN. Sentosa është një nga 63 ishujt që përbëjnë Singaporin. Ishulli me territor prej 500 hektarësh është vendi i hoteleve luksoze, klubeve të golfit dhe zonave detare private. Mirëpo ishulli po ashtu ka një histori të zymtë të luftës dhe gjakderdhjeve. (REL)



Në bazë të nenit 22 paragrafi 2 të Ligjit për planifikim hapësinor dhe urbanistik ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë nr. 199/14, 44/15, 193/15, 31/16, 163/16 dhe 64/18), Ministri i Ministrisë së transportit dhe lidhjeve publikon

THIRRJE PUBLIKE

Për dorëzimin e propozimeve për përpilim të planeve urbanistike, planeve të rregullimit të planeve të përgjithshme urbanistike, dokumentacioneve urbanistike-planore dhe dokumentacioneve urbanistike-projektuese

Për shkak të nxitjes dhe përsheptimit të procesit të rregullimit të hapësirës, Qeveria e Republikës së Maqedonisë sjellë Program vjetor për financim të përpilimit të planeve urbanistike, planeve të rregullimit të planeve të përgjithshme urbanistike, dokumentacioneve urbanistike-planore dhe dokumentacioneve urbanistike-projektuese me propozim të Ministrisë së transportit dhe lidhjeve

Informohen komunat, komunat e Qytetit të Shkupit dhe Qyteti i Shkupit se publikohet **Thirrje publike** për dorëzimin e propozimeve dhe përpilim të të planeve urbanistike, planeve të rregullimit të planeve të përgjithshme urbanistike, dokumentacioneve urbanistike-planore dhe dokumentacioneve urbanistike-projektuese.

- **Thirrja publike do të zgjasë prej 08.06.2018 deri më 09.07.2018**, në të cilin afat do të mund të dorëzohen propozimet për përpilimin e planeve urbanistike, planeve të rregullimit të planeve të përgjithshme urbanistike, dokumentacioneve urbanistike-planore dhe dokumentacioneve urbanistike-projektuese. Propozimet të cilat nuk do të dorëzohen gjatë thirrjes publike nuk do të jenë lëndë shqyrtimi.
- **Shpallja publike do të publikohet** në sistemin informativ e-urbanizam dhe në ueb faqen e Ministrisë së transportit dhe lidhjeve në adresën në vijim www.mtc.gov.mk (si dhe në dy gazeta ditore).
- **Komunat, komunat e Qytetit të Shkupit dhe Qyteti i Shkupit** propozimet për përpilim të planeve urbanistike, planeve të rregullimit të planeve të përgjithshme urbanistike, dokumentacioneve urbanistike-planore dhe dokumentacioneve urbanistike-projektuese mund gjatë thirrjes publike t'i dorëzojnë deri në Ministrinë e transportit dhe lidhjeve në formë elektronike përmes sistemit të informimit e-urbanizam ose në formë me shkrim.
- Përpilimi i planeve urbanistike, planeve të rregullimit të planeve të përgjithshme urbanistike, dokumentacioneve urbanistike-planore dhe dokumentacioneve urbanistike-projektuese të përcaktuara në Programin vjetor për financim dhe përpilim të planeve urbanistike, planeve të rregullimit të planeve të përgjithshme urbanistike, dokumentacioneve urbanistike-planore dhe dokumentacioneve urbanistike-projektuese për vitin 2018 bëhet nga ana e Agjencisë për planifikim të hapësirës.
- Përpilimi i planeve urbanistike, planeve të rregullimit të planeve të përgjithshme urbanistike, dokumentacioneve urbanistike-planore dhe dokumentacioneve urbanistike-projektuese të përcaktuara në Programin vjetor për financim të përpilimit të të planeve urbanistike, planeve të rregullimit të planeve të përgjithshme urbanistike, dokumentacioneve urbanistike-planore dhe dokumentacioneve urbanistike-projektuese për vitin 2018 financohet nga Buxheti i Republikës së Maqedonisë. Me përjashtim të asaj të theksuar më lartë, përpilimi i planeve urbanistike, planeve të rregullimit të planeve të përgjithshme urbanistike, dokumentacioneve urbanistike-planore dhe dokumentacioneve urbanistike-projektuese mund të financohet edhe nga Buxheti i komunave, komunave të Qytetit të Shkupit, si dhe nga ana e palëve të interesuara juridike dhe fizike.

Ministër i transportit dhe lidhjeve
Goran Sugareski



FONDI I SIGURIMIT PENSIONAL DHE INVALIDOR I MAQEDONISË

SH P A L L J E

PASQYRË E PJESËVE NË PRONË TË FONDIT QË DO TË OFROHEN PËR SHITJE NË BURSËN E MAQEDONISË PËRMES ANKANDIT PUBLIK BURSAR NË TRE DITË RRESHT TË TREGËTIMIT, DUKE FILLUART NGA 26.06.2018

Numër rend.	Shoqëria aksionare	Vendi	Pjesa kryesore e shoqërisë në denarë	Vlera nominale e pjesëve për shitje në denarë	Pjesëmarrja e pjesëve në pjesën kryesore të shoqërisë në %	Çmimi fillestar shitës i një pjese në denarë
1	SHPK BYRO PËR SHËRBIME TË KONTABILITETIT	Strumicë	346.239	51.925	15,00%	51.925
2	MZT IRI SHPK Shkup	Shkup	1.055.900	432.000	40,91%	432.000
3	NACIONAL SHPK	Strumicë	22.272.625	2.266.577	10,18%	2.266.577
4	DULE PROM 1 SHPK	Tetovë	1.131.500	195.800	17,30%	195.800
5	NOV ZHIVOT SHPK	Shkup	2.824.600	423.700	15,00%	423.700
6	IZOLACIJA SHPK	Shkup	7.305.553	215.553	2,95%	215.553
7	ANEV SHPK	Kavadar	341.500	74.600	21,84%	74.600

Pjesët do të ofrohen për shitje përmes bursës së Maqedonisë në tre ditë rresht të tregëtimit duke filluar nga 26.06.2018. Pajesa do të bëhet në para të gatshme dhe në denarë.

FONDI I SIGURIMIT PENSIONAL DHE INVALIDOR I MAQEDONISË
www.piom.com.mk



Në bazë të nenit 17 të Vendimit për punën e Këshillit për ndarjen e Çmimit "13 Nëntori" të Qytetit të Shkupit, Këshilli për ndarjen e Çmimit "13 Nëntori" të Qytetit të Shkupit në seancën e mbajtur më 5 qershor 2018, shpall

KONKURS

për ndarjen e Çmimit "13 Nëntori" të Qytetit të Shkupit për vitin 2018

1. Çmimi "13 Nëntori" i qytetit të Shkupit u ndahet **personave fizik dhe juridik** si shenjë mirënjohjeje e Qytetit të Shkupit, për **arritje**, në ekonomi, shkencë, art, kulturë, edukim dhe arsim, mbrojtje shëndetësore, mbrojtje sociale, sport dhe kulturë fizike, kulturë teknike, mbrojtje dhe përmirësim i ambientit jetësor dhe natyrës, si dhe në segmente të tjera të jetës, punës dhe krijimit, që përbëjnë **kontribut të veçantë dhe për zhvillimin e Qytetit dhe për përparimin e përgjithshëm e afirmimin** në Republikën e Maqedonisë dhe në botë.
2. Çmimi për arritje të rëndësishme në fushat e pikës së mëparshme u ndahet edhe personave fizik dhe juridik **nga shtete të tjera**.
3. **Studentëve dhe nxënësve** Çmimi u ndahet për punë krijuese ose arritje të suksesshme në kontinuitet në aktivitetet shkollore dhe jashtëshkollore që përbëjnë një kontribut të veçantë për përparimin dhe afirmimin e Qytetit të Shkupit.
4. Çmimi ndahet për arritje në **periudhën e kaluar prej një viti** (llogaritur deri në përfundimin e konkursit), si dhe për një periudhë më të gjatë që përbën **përmbylljen e një pune krijuese ose në kontinuitet në tërësi**.
5. Për individë, grupe krijuesish, nxënës dhe studentë Çmimi përbëhet nga **diploma dhe shumë në të holla**.
6. Çmimi për persona juridik nga vendi dhe persona juridik nga shtete të tjera përbëhet nga diploma dhe pllakate.
7. Të drejtën për propozimin e kandidatëve për Çmimin "13 Nëntori" kanë persona juridik dhe fizik.
8. Çmimi mund t'i ndahet përsëri fituesit të mëparshëm, por jo para afatit prej 10 vitesh nga marrja e çmimit të fundit.
9. Propozimi për Çmimin duhet të arsyetohet në mënyrë të hollësishme, kurse për kandidatë individë duhet të ketë edhe biografi.
10. Bashkë me propozimin për ndarjen e Çmimit për vepra të botuara dhe botime të tjera bashkëngjiten edhe (2) kopje të veprës.
11. Konkursi zgjat deri më 10 shtator 2018.

Parashtuesi duhet të japë emërtimin e tij të plotë, adresën dhe numrin e telefonit.

Formulari për konkurrimin për Çmimin "13 Nëntori", mund të merret në zyrën pritëse të Qytetit të Shkupit ose të gjendet në ueb faqen www.skopje.gov.mk.

Propozimet i dorëzohen në tre kopje Këshillit për ndarjen e Çmimit "13 Nëntori" të Qytetit të Shkupit (Qyteti i Shkupit – Parku i Qytetit), zyra pritëse. Informacion në tel. 3297-358.

KËSHILLI PËR NDARJEN E ÇMIMIT
"13 NËNTORI" TË QYTETIT TË SHKUPIT

Nji gramatikë e gegnishtes asht ma se e nevojshme për me krijue ma n'fund bazën e nji gegnishte të përbashkët letrare, së paku (fillimisht) mbrenda Shqipniet. Propozimi im nënkupton punë serioze, angazhim dhe përkushtim specialistësh gjuhëtarë dhe shkrimtarësh që e praktikojnë dmth. e shkruajnë gegnishten

Nga Andreas Dushi /Konica.al

Për fat të keq, sa herë që lexon komente të shkruara gjoja në gegnisht apo poezi që shkruhen me këtë dialekt, shqetësohesh pasi dy gegë nuk përdorin të njëjtën gegnishte. Ky është problemi që ka vënë në dukje në një shkrim, profesori i mirënjohur gjerman dhe miku i shqiptarëve Hans Joachim Lanksch:

Kur lexon shkrimet e komentet e gegeve dhe gegëve tanë në këte grup interneti dhe gjetiu, të zë zgjeba. Çdonjeni dhe çdonjena shkruen ndryshe, simbas qejfit të vet. Kjo s'asht gjuhë por nji idiomë lesh e li. Nuk asht për t'u çuditë se jo-

Intelektuali, pjesëmarrës i deformimit "DEMOKRATIK"



Këto ditë, sociologu Ibrahim Berisha publikoi librin e vet më të ri me ese sociologjiko-kulturologjike, me titull Urtia e Pafuqishme. Libri është ndërtuar në katër kapituj, në

të cilët shkruhet për shoqërinë e Kosovës mbas vitit 2000. Rishfaqje dhe shfaqje të temave socio-kulturore që tregojnë paradokse dhe funksione të konstrukteve inerte të legjitimuara si dinamike, të cilat jetojnë duke qëndruar ndërmjet pushteteve informale shumë më shumë se sa atyre formale, transmeton Koha.net.

Në fokus është vënë intelektualit që shpreh pjesën aktive të sistemit të deformuar formal-publik, duke qenë edhe vetë pjesë e korrupsionit etik në shërbim të politikës informale, por edhe duke shfrytëzuar aktivisht këtë deformim "demokratik". Në këtë frymë, transformimi dhe transiconi shoqëror dhe politik, ringonfiguron profilin sistemor të të privilegjuarve administratorë, të cilët bashkohën në aspiratën e fiseve politike me ato intelektuale për t'u fshehur pas turmës që është streha mbuluese e aksioneve dhe misionëve "të shenjta".

A MUND TË KEMI NJË GEGNISHTE LETRARE?



gegët e quejnë gegnishten "dialekt".

Nga ana tjetër as nuk asht çudi se gegnia shkruajnë siç flasin në shpi, në rrugë apo në stadium futbollit. Shqipja geqe nuk jepet nëpër shkollë. Nuk ekziston ndonji gramatikë të botueme dhe aktuale, kusht për çdo gjuhë letrare.

Mësova që ekziston dorëshkrimi i manualit të Martin Camajit, "Albanian Grammar". Dorëshkrimi ruhet si dhe trashigimia e tij letrare

në arhivin letrar të Mynihut, znj. Camaj e ka të fotokopjueme.

Dorëshkrimi i Martin Camajit asht shkruar në shqip dhe pjesërisht në gjermanisht.

"Albanian Grammar" përmban edhe leksione me ushtrime për përdorues anglishtfolës që duen me ta mësue shqipen, edhe pjesë gramatikore.

Propozoj me nxjerrë pjesët (shpjegimet) gramatikore, tabelat

gramatikore si dhe tekste këndimi. Pjesë përmbamëse gjermanisht mund të përkthehen shqip (gegnisht) e kështu krijohet nji gramatikë e gegnishtes letrare moderne që mundet me shërbye si bazë për gegnishten letrare.

Mendoj se nji gramatikë e gegnishtes asht ma se e nevojshme për me krijue ma n'fund bazën e nji gegnishte të përbashkët letrare, së paku (fillimisht) mbrenda Shqipniet.

Propozimi im nënkupton punë serioze, angazhim dhe përkushtim specialistësh gjuhëtarë (p.sh. prof. Arben Prendi, ak. Koleç Topalli) dhe shkrimtarësh që e praktikojnë dmth. e shkruajnë gegnishten (p.sh. Primo Shllaku, Lisandri Kola, Ledia Dushi) e të tjerë që nuk i njoh apo nuk po më bien ndërmend. Propozim-projekti nënkupton edhe lekë...

Në fund, mendoj se kjo ndërmarrje kuptimplotë mundet me u përballue me vullnesën e fortë e të përbashkët të krejt atyne që e kanë për zemër gjuhën geqe.

Zbulohet qyteti ilir i para 2300 vjetëve

Në pamje të parë i ngjante vetëm një toke bujqësore. Deri në vitet 1990 aty qe vendosur edhe një repart tankesh.

Në vitet 1980 u gjetën krejt rastësisht varre antike, mandej një fontanë e prapë, ajo dukej si një fushë krejt e zakonshme, derisa një grup arkeologësh duke përdorur metoda invazive, hasi në anomalitë që çuan më pas në

një zbulim.

Një qytet ilir rreth 2300-2400 vjeçar ka dalë në dritë në zonën e Bushatit në Shkodër, gjatë gërmimeve arkeologjike të ekspeditës shqiptaro-polake. Saimir Shpuza në një intervistë për "Gazeta Shqiptare" thotë se lulëzimi i tij u shënuar në shekujt 4-2 para erës sonë dhe se me rënien e mbretërisë ilire të Ardianëve, qyteti pësoi rënie graduale deri sa u braktis totalisht. I shtrirë në rreth 20 ha, sipërfaqja e tij është e përafërt me qytetet e tjera të mëdha të zonës si Shkodra dhe Lezha. Shpuza thotë se ende nuk është mësuar se cili ka qenë emri antik të këtij qyteti. Por pikërisht ky eksplorim drejt së panjohurës e bën punën e arkeologut ende më të bukur.



"Kala", festivali i parë ndërkombëtar i muzikës në Shqipëri

Blogu i famshëm londinez "STW" (Stamp the Wax) ka marrë në një intervistë të rrallë organizatorët e festivalit të parë ndërkombëtar të muzikës në Shqipëri, që titullohet "Kala". Në këtë intervistë unike organizatorët shpalosin detajet dhe sekretet që ky festival do t'u ofrojë gjithë të pranishmëve.

Franca dhe Kanadaja që të dyja kanë pretendime të larta për Rivierën e tyre, mbushur plot resorte luksoze për të kaluar pushimet nën



valën e ish-lëvizjes së muzikës "dance" të viteve më parë që ka përfshirë të gjithë botën. Shqipëria nuk shfaqet si një tjetër destinacion i këtij lloji, por e fshehur në

lindje të Italisë ka një vijë bregdetare të pastër dhe gjerësisht të paprekur nga turizmi dhe muzika.

Por fillimi i festivalit "Kalaja" këtë vit synon të sjellë ndryshime,



Princesha Maxhide, ajo që udhëhoqi revolucionin kundër ferexhesë

Ajo duket e buzëqeshur, veshur me një fustan të lehtë mëndafshi të gjatë. Është princesha Maxhide, një prej motrave më të përfolura të mbretit Zog, për bukurinë dhe zgjuarsinë që mbarte. Kjo është vetëm një prej fotove të mbetura nga ajo kohë, kur Maxhide nuk e fsheh lumturinë në fytyrë. Por ajo kujtohet dhe si gruaja që ndikoi në emancipimin e femrës shqiptare. Gazeta franceze, "Paris-soir", ka botuar, të premtën e 26 nëntorit 1937, në faqe të parë dhe të shtatë një shkrim për princeshën Maxhide dhe emancipimin e grave shqiptare. "Ndodhi një revolucion i vërtetë. Pranverën e kaluar, një dekret i Mbretit Zog të Shqipërisë shpalli barazinë mes gruas dhe burrit, dhe ndaloi ferexhen në të gjithë mbretërinë, e cila ishte vendi i fundit në Ballkan që u qëndronte ende besnik shumicës së traditave myslimane. Pra, nesër, në përvjetorin e çlirimit të Shqipërisë, një batalion i grave do të marrë pjesë në paradën e madhe ushtarake. « Amazonat » e reja do të paraqiten me uniformën e zakonshme ushtarake : kaskën, çizmet, maskën e gazit, pushkën dhe mitralozin.

Ato do të komandohen nga Princesha Maxhide, një nga gjashtë motrat e Mbretit Zog, gruaja që ka bërë më së shumti për emancipimin e grave shqiptare. Ajo mban gradën e togerit në gardën mbretërore. Nga ferexheja tek mbajtja e kaskës, në tetë muaj, gratë e Shqipërisë kanë bërë një rrugë të gjatë për t'u çliruar nga tutela mashkullore.", thuhet në shkrimin e plotë të gazetës përkthyer në shqip nga Aurenc Bebja. (gazeta-Shqip.com)

duke shënuar gjithashtu festivalin e parë ndërkombëtar të muzikës në Shqipëri. Me një kurim në detaje dhe një organizim krijues, kalendari i programit është i përllogaritur me kujdes përgjatë një jave. Kjo është një ofertë e re dhe tërheqëse për rrethin europian të festivalit. Ende i fshehur pas vellos së edicionit debutues, biseduam me drejtuesit për të zbuluar më shumë në lidhje me origjinën e festivalit dhe t'i hedhim një sy zonës përreth. /ATSH

Muarem, përforcimi i parë i FC Shkupi

Shkup, 6 qershor - Muarem Muarem është përforcimi i parë i FC Shkupi. Futbollisti shkupjan është prezantuar dje me skuadrën e tij të re, pasi ka firmosur edhe kontratën përkatëse me kohëzgjatje prej dy viteve. Lajmi është konfirmuar nga faqja zyrtare e FC Shkupi, që ka postuar edhe fotot e prezantimit, ndërsa menjëherë pas kësaj ka folur edhe vet Muarem Muarem. "Sigurisht se ndjem lumtur që pas 11 viteve kthehem në klubin e dashurisë, Shkupin dhe lagjen time Çairin nga edhe e



fillova jetën e një futbollisti profesionist. Shpresoj të adaptohem shumë shpejt me ekipin dhe të jap ndihmën time në realizimin e

projekteve të kryesisë, ndërsa tani me pjesëmarrjen në Ligën e Evropës, klubi do ketë mundësi që përsëri të kthejë famën e dikurshme", deklaroi Muarem. Ndryshe, Muarem së fundmi ka luajtur për Flamurtarin nga Vlora, derisa hapat e parë i ka bërë pikërisht te FC Shkupi, ndërsa në të kaluarën ka pasur një karrierë të pasur duke luajtur për Rabotniçkin, Teteksin, Orduspor, Karabak, Eskishehirspor, Karabak, Aktobe dhe siç thamë Flamurtarin nga Vlora. (B.K.)



Mavraj pranë kalimit në Superligën turke

Mërgim Mavraj, mbrojtësi i Kombëtares shqiptare është shumë pranë kalimit në Superligën turke pas eksperiencës jo shumë të mirë me skuadrën e Hamburgut në Gjermani. Lajmin e ka bërë të ditur "Panorama Sport", teksa shkruan se tentativat janë në fazën finale mes mbrojtësit kuqezit dhe Fenerbahçes. 31-vjeçari është një nga futbollistët që numëron 40 ndeshje me përfaqësuesen, si dhe një karrierë të pasur në Gjermani. Megjithatë, skuadra turke ka treguar interes për shërbimet e mbrojtësit shqiptar për të përforcuar më shumë repartin e prapavijës për sezonin e ardhshëm.

ADNAN JANUZAJ INTERVISTOHET NGA MEDIAT SPANJOLLE

BOTËRORI NJË MUNDËSI E MADHE, MESSI MË I MIRI

Në një intervistë për mediat spanjolle, Januzaj është shprehur duke thënë se, Botërorin e sheh si një mundësi shumë të madhe për të edhe shokët e skuadrës



Andan Januzaj në këtë botëror pritet të jetë futbollisti i parë Belge, i cili ka luajtur në dy edicione pa marrë pjesë në asnjë eliminatore. Januzaj u përzgjedh nga trajneri midis 23 futbollistëve për kombëtaren e Belgjikës që do të luftojnë për trofeun e Kupës së Botës. Januzaj, është duke u përgatitur me shumë entuziazëm, për këtë pjesëmarrje të dytë. Në një intervistë për mediat spanjolle, Januzaj është shprehur duke thënë se, Botërorin e sheh si një mundësi shumë të madhe për të edhe

shokët e skuadrës. "E pres me padurim këtë Botëror. Të gjithë kemi luftuar në maksimum për të qenë pjesë e listës dhe tani tifozët mendojnë se mund të bëjmë një rrugëtim të mirë. Kemi shumë lojtarë të mirë që po luajnë në nivelet më të larta ndërkombëtare dhe në kampionatet më të forta. Tani mbetet të ndërtojmë një ekip të fortë me

ta, të punojmë si skuadër. Kjo është një mundësi e madhe që u jepet të gjithëve. Sigurisht, ne dhe Anglia kemi më shumë lojtarë në kampionatet e forta sesa rivalët në grup. Por në Kupën e Botës nuk mund të mendosh se ke fituar çdo ndeshje dhe duhet të tregosh gjithmonë se je superior ndaj rivalit që ke përballë", është sh-

prehur mesfushori. I pyetur se cili është ekipi të cilin Januzaj e sheh si favorit për të fituar këtë kompeticion, mbrojtësi tha: "Gjermania ka një grup të fortë lojtarësh dhe paraqitet gjithmonë mirë në këto aktivitete. Brazili dhe Spanja kanë lojtarë shumë të mirë, me një stil të tyrin të lojës që po u jep rezultatet të mira prej viteve. Dhe Argjentina ka Messin. Mendoj se ka shumë presion mbi të, ndonëse mendoj se për të kjo nuk është asgjë. E përmenda pasi ai është lojtari më i mirë mes atyre që janë në Botëror. Mos harroni se Argjentina gjithashtu ka Agueron, Di Marian apo Higuain, sa për të përmendur disa. Por Messi është qartësisht më i miri, i Argjentinës dhe i gjithë kombëtareve të tjera. Askush tjetër nuk ka talentin e tij. Unë jam mes atyre që mendojnë se është një futbollist nga një planet tjetër", përfundoi deklaratën Adnan Januzaj.

UEFA SHPËRBLËN KLUBET NGA MAQEDONIA



Shkëndija arkëton 800 mijë euro

Shkup, 6 qershor - Shtëpia e Futbollit Evropian, shpalosi shumat e të hollave të cilat do të përfitojnë klubet në garat evropiane. Kampioni aktual, Shkëndija do të përfitojë rreth 800 mijë euro, pasi që vet pjesëmarrja në eliminatorët e Ligës së Kampionëve sjell 260 mijë, ndërsa ndeshjet në raundin parë do të rrisin buxhetin e skuadrës tetovare për 280 mijë euro. Edhe me eliminim, Shkëndija do të arkëtojë plus 240 mijë euro, ndërsa kalimi në raundin e dytë sjell ekstra 380 mijë euro. Ndërkohë, skuadrat që garojnë në Ligën Evropë, Vardari, Rabotniçki dhe FC Shkupi, do të përfitojnë nga 500 mijë euro. Në rast se kalojnë raundin e parë, ata do të përfitojnë rreth 280 mijë euro të tjera. Shorti për Ligën Evropë do të zhvillohet më 19 qershor.

PASI FITOI MEDALJEN E ARGJENDTË NË KE NË SHKUP

Alili pritët nga Kaeski dhe Tupurkovski

Shkup, 6 qershor - Pas medaljes së argjendtë të fituar në Kampionatin Evropian për kadetë që u zhvillua në Shkup, Besir Alili, bashkë me seleksionuesin Sedat Baftiu, kryetarin e Federatës së Mundjes të Maqedonisë, Betim Vrenezi dhe nënkryetarin Dejan Bogdanov, gjatë ditës së djeshme u pritën nga ana e drejtorit të Agjencisë për Rini dhe Sport, Darko Kaeski. Kaeski, mes tjerash e përgëzoi Alilin për këtë arritje të madhe, duke e uruar që këtë rezultat ta përsërit edhe në Kampionatin Botëror, që do të mbahet në Zagreb muajin e ardhshëm. "Jam i nderuar që sot në



hapësirat e ARS-së e pritëm njërin prej mundësve më të talentuar Besir Alili, i cili e fitoi vendin e dytë dhe u stolis me medaljen e argjendtë në KE për kadet i cili u

mbajt në Maqedoni. I dëshiroj sukses të mëdha në të ardhmen dhe shpresoj se do të tregohet edhe më i mirë në Kampionatin Botëror, i cili muajin e ardhshëm do të

mbahet në Zagreb", deklaroi Kaeski. Ndërkohë, Besir Alilit më pas pritet i ka bërë edhe kryetari i Komitetit Olimpik të Maqedonisë, d-r. Vasil Tupurkovski, i cili uroj Alilin për medaljen e fituar në KE stil i lirë dhe të njëjtit i dëshiroi rezultate edhe më të mirë dhe gjithashtu ti hakmerret mundësit armen Rafael Harytunijan, prej të cilit humbi në finale në KE për kadet në Shkup. Gjithashtu në këtë takim prezent ishin edhe seleksionuesi Sedat Baftiu, kryetari i Federatës së Mundjes të Maqedonisë, Betim Vrenezi nën nënkryetari Dejan Bogdanov. (B.K.)

“BOMBA” E MERKATOS

SALLAH I VETËOFROHET GJIGANTËVE TË EVROPËS

Në ditët e fundit, në fakt, ka pasur disa takime mes njerëzve të besuar të lojtarit dhe drejtuesve të klubit blaugrana për të vetmin qëllim: vlerësimin e të ardhmes së egjiptianit dhe mundësisë së marrjes së tij në “Camp Nou”. Barcelona, e cila ka folur edhe me njerëzit e Grizmann, si të njohurin Guillermo Amor, është e hapur për çdo mundësi që të përforcojë një zonë të fushës, që ende e konsideron zbuluar, pavarësisht ardhjes së Dembele, verën e kaluar

Mohamed Salah mund të bëhet alternativë për Grizmann, në merkaton verore të Barcelonës. “AS” ka qenë në gjendje të mësojë se sulmuesi egjiptian i është ofruar skuadrës katalanase nga mjedisi i tij i afërt dhe në këtë kohë ka negociata të hapura. Në ditët e fundit, në fakt, ka pasur disa takime mes njerëzve të besuar të lojtarit dhe drejtuesve të

klubit blaugrana për të vetmin qëllim: vlerësimin e të ardhmes së egjiptianit dhe mundësisë së marrjes së tij në “Camp Nou”. Barcelona, e cila ka folur edhe me njerëzit e Grizmann, si të njohurin Guillermo Amor, është e hapur për çdo mundësi që të përforcojë një zonë të fushës, që ende e konsideron zbuluar, pavarësisht ardhjes së Dembele, verën e kaluar. Opsio-

ni “Salah” do të ishte alternativa më e mirë e mundshme për Grizmann. Egjiptiani është emëruar lojtari më i mirë i Premier Ligës në sezonin e fundit dhe ishte gola-shënuesi më i mirë, me 32 gola. Hap cilësor, gjithashtu, ka rezultuar për të sezoni fenomenal në Ligën e Kampionëve, ku ai arriti në finale dhe vetëm një lëndim në ndeshjen finale kundër Real Ma-

dridit, në Kiev, e ka privuar atë nga lufta për titullin. Përveç kësaj, ai e ka kualifikuar Egjiptin për në Kupën Botërore të Rusisë dhe do të jetë yll i “faraonëve” në këtë turne të kësaj vere, pavarësisht se është dëmtuar në shpatull. Ashtu si me të gjitha yjet e veta, Liverpooli është i gatshëm ta shesë Salah, megjithëse do të kërkojë më shumë se 100 milionë euro.

PAS AKUZAVE TE TURES KUNDREJT TRAJNERIT TË SITIT

De Bryne i del në mbrojtje Guardiols

Jaja Ture u kufizua në një rol të vogël në sezonin e tij të tetë dhe të fundit të Manchester Siti, pasi Pep Guardiola e drejtoi klubin drejt fitimit dominant të titullit në Premier Ligë dhe në “Carabao Cup”. Ndeshja e vetme si startues në sezonin e fundit të Premier Ligës e 35-vjeçarit erdhi si kapiten, në paraqitjen e tij të lamtumirës, ndaj Brajton dhe Hove Albion, me titullin e fituar tashmë. Në një intervistë të mahnitshme me “France Football”, ish-mesfushori i Barcelonës pretendoi se koha e duetit së bashku në Katalonjë hapi rrugën për një sezon final të pakëndshëm në Angli. Ture akuzoi Guardiolen se ishte i motivuar nga “hakmarja” dhe “xhelozia”. Derisa, De Bryne u gjykua gjerësisht si interpretuesi i yllit të Manchester Sitit në renditjen rekord të titullit të Premier Ligës. Belgu beson se ka pasur arsye shumë më pak konspirative për shokun e tij të ekipit, që të bënte të tilla deklarata kundër trajnerit Guardiola. “Nuk e di se çfarë ka thënë Jaja, ose nëse është gabimisht e shkruar, apo e ekzagjeruar. Kur nuk luani, gjithnjë ka diçka që përpiqeni ta gjeni”, – tha mesfushori i Belgjikës për “BBC



World Football”. – Ne kishim sezonin më të mirë ndonjëherë, kështu që në fund trajneri mori vendimin e duhur për të luajtur me ekipin që pati më shumë aktivizim. Pra, këtë vit trajneri ndoshta mendoi se Jaja nuk ishte duke bërë mjaft, nuk ishte i aftë mjaftueshëm”, shtoi më tej Bryne. Ture u dëbua nga skuadra e parë gjatë ditëve të para të mbretërimit të Guardiols në vitin 2016, pasi u rikthye për mbipeshë para sezonit. Por, ai punoi përsëri në favor të trajnerit katalanas,

pas një spazme midis Guardiols dhe agjentit të tij, Dimitri Seluk, për të fituar një zgjatje 1-vjeçare të kontratës. Seluk pretendoi se klienti i tij është i gatshëm t’i propojë Guardiols gabimin që ka bërë me të dhe propozoi skenarin, në dukje të vështirë, që Ture të vijojë duke luajtur për një pagë bazë prej 1 sterlina në javë. “Tani, Jaja ka shumë oferta nga vende të ndryshme, ku janë të gatshëm të paguajnë shumë para, por vendosëm t’ia dedikojmë sezonin e ardh-

shëm Guardiols, – tha ai për “Sport24”. – Në një kohë kur shumata mëdha janë duke u shpenzuar në Angli për blerjen e lojtarëve të futbollit, zyrtarisht deklaroi se Yaya është gati të lëvizë si lojtar i lirë në çdo klub të lartë anglez, me një pagë prej 1 euro në javë, me disa suksese, që rezultojnë në formë bonusesh”. Kur u kontaktua nga “Omnisport”, Manchester Siti refuzoi të komentojë lidhur me pretendimet e mëtejshme të Tures në intervistë.



Asnjë ofertë për Donnarumman

Milani ishte i angazhuar për shërbimet e portierit Pepe Reina, teksa ky i fundit mbylli tri sezoneve në nivele të larta me Napolin. Në fakt, ndjenja te kuqezinjët ishte ajo se në fund të sezonit, Gjanluigi Donnarumma mund të largohet nga Milani për ndonjë klub evropian të madh. Mirëpo, për momentin gjithçka në këtë drejtim është e mbuluar nga heshtja. Situata, siç është raportuar nga “La Gazzetta dello Sport”, pas “fishkëzjarrëve” të sezonit të kaluar, tani është pezulluar. Në “Via Aldo Rossi” nuk ka mbërritur asnjë ofertë për “mbrojtësin ekstrem”. Mesa duket, interesi për të ka rënë, pas disa gabimeve serioze të bëra në muajt e fundit muaj. Mes menaxherit të lojtarit, Mino Raiola, dhe klubit milanez është vendosur një lloj armëpushimi. Kjo shpjegohet, gjithashtu, me fjalët e agjentit, i cili, midis seriozitetit dhe provokimit, deklaroi kohët e fundit: “Gigio mund të mbetet përjetë te Milani”. Klubi kuqezij, nga ana e tij, në mungesë të një klauzole mbi kontratën, e di se e “ka thikën në anën e dorezës” dhe mund të vendosë se kush ta shesë lojtarin. Pra, Milani nuk është i gatshëm të bjerë nën vlerësimin e tij të kartonit të portierit, sigurisht mbi 50 milionë euro. “Gjigjio është një pasuri që duhet mbrojtur, – ka thënë klubi kuqezij disa herë, – por nëse vjen një ofertë e kënaqshme dhe Gjigjio është në rregull, ne do të jemi gati ta diskutojmë atë”. Nëse çmimi është pothuajse i fiksuar, me pak fjalë, nuk ka afate kohore. Donnarumma mund të transferohet edhe në orën e fundit të ditës së fundit në dispozicion të merkatos verore. Milani, në fund të fundit, në mes të shtyllave ndihet i mbuluar. Nëse do të qëndronte Donnarumma, ai do të konfirmohej si portieri i parë, ndërsa Reina, i cili do të luajë Kupën e Botës me Spanjën, do të jetë zëvendësuesi i tij.

PLATINI ME AKUZA TË FORTA KUNDREJT FIFA-s

JENI NJË TUFË BUDALLENJSH

Kam humbur 4 vjet nëpër komisione dhe duke iu shpjeguar gazetarëve gjithmonë të njëjtat gjëra. Duhet t'i rikuperoj. Nuk dorëzohem deri sa të pranojnë se nuk kam bërë asgjë kundër etikës, që jam pa njollë. Ata të komisioneve janë budallenj dhe me ata do të merrem", pohon Platini



Michel Platini është hedhur në sulm, atë që vite më përpara ka ditur të bëjë më mirë. Ai ka bërë një dalje për mediat pas një kohë relativisht të gjatë në afërsi të Udines, në Itali, dukë luajtur golf me miqtë. "Jam mirë, po zbuloj jetën e një njeriu normal. Tani që është e qartë se nuk jam i korruptuar dhe nuk kam vjedhur, nuk jam ai që kanë thënë një tufë budallenjsh të Komisionit të Etikës, ndihem ndryshe. Dhe do t'i sulmoj", thotë fillimisht Platini. "Një mik më tha: shiko, po bëjnë diçka kundër teje. Nga ai moment ishte gjithçka një makth. Kaloja nga njëri komision te tjetri, i sigurt për pafajësinë time, por më pas u dënova 8 vjet, më pas 6, më pas 4. Njerëzit e kuptuan se ishte gjithçka false, gjithçka e planifikuar", shtoi më tej Platini, i cili më pas ngriti akuzat kundrejt FIFA-s. "Ishin të gjitha idiotësi të FIFA-s për mua. Ishte shumë e vështirë për mua. Familja dhe miqtë e vërtetë më njohin mirë, por të tjerët në fakt, për pak kohë

menduan se isha një bandit. Vetëm për pak. Nëse do t'i kisha komunikuar direkt UEFA-s për paratë që mora nga FIFA? Nuk e dija që duhej ta bëja. Ato para i deklarova në tati me, pagova kontributet. Nuk desha t'i fshihja. Pastaj, avokatët e FIFA-s nuk paguhen për të mbikëqyrur zëvendës-presidentët? Pse nuk ma thanë?", vazhdon Platini. "Kam humbur 4 vjet nëpër komisione dhe duke iu shpjeguar gazetarëve gjithmonë të njëjtat gjëra. Duhet t'i rikuperoj. Nuk dorëzohem deri sa të pranojnë se nuk kam bërë asgjë kundër etikës, që jam pa njollë. Ata të komisioneve janë budallenj dhe

me ata do të merrem". Ndryshe, Platini ka folur edhe për zgjedhjet. "Procesi nuk ka përfunduar. Blatter është ende në gjykim. Nuk kam folur kurrë me të kohët e fundit. A do të kthehem pas skualifikimi, që përfundon në tetor të 2019-ës? Zgjedhjet janë në qershor, kështu që nuk mund të shkoj. Kam parë fytyrën e zezë të futbollit. Nuk e prisja. Iu futa kësaj pune për ta zhvilluar futbollin, për të zhvilluar fëmijët, jo për t'u mbrojtur. Nuk ka asgjë që nuk do të doja ta bëja. Kam bërë drejt gjithçka. Gjithçka u komplikua, kur Blatter, në Kongresin e UEFA-s në Paris tha: Është

mandati im i fundit, më votoni! Pas 4 vjetësh do të jetë radha e Platini-së". Në fund Platini ka folur për veten dhe "Fair-Play"-in. "Për UEFA-n dhe FIFA-n nuk më bëhet vonë. Më vjen keq vetëm për faktin se shikimi i njerëzve ndaj meje kishte ndryshuar. Më shërbeu për autokritikë. Mendoja se isha i rëndësishëm. Njerëzve nuk u plas për presidentët, atyre u interesojnë Mesi, Ronaldo, Ibra. Tani mund të jetoj si një njeri normal. Fair-play? Shpëtova futbollin nga falimentimi. Një FIFA elegante dhe kurajoze do të bënte diçka për mua", ka përfunduar Platini.



E KËRKON GJYSMA E EVROPËS Braziliani është një hap larg Interit

Interi është shumë afër realizimit të një blerje të madhe në merkato. Zikaltrit kanë arritur marrëveshjen verbale me Malkom, ylli i Bordos. Braziliani do vetëm zikaltrit dhe duket se ka refuzuar ofertat e Paris Sen Zhermen, Liverpool dhe Borussia Dortmund. Takimi i zhvilluar mes Piero Ausilio dhe stajit të lojtarit ka shkuar mirë. Tani, Interi duhet të gjejë një marrëveshje me klubin francez, që kërkon 50 milionë euro për Malkom. Milanезët kanë ofruar 40. Palët po studiojnë një formulë që mund t'i kënaqë të gjithë. Nga ana e tij, trajneri Luciano Spalletti pret dhuratën e radhës pas De Vrij, Asamoah dhe Lautaro Martinez. Dhe mund të jetë pikërisht Malkom (12 gola dhe 7 asistime në Ligue 1 këtë vit). Gjithashtu, zikaltrit po punojnë të gjejnë një marrëveshje me Barcelona-n për të rinovuar huazimin e Rafinja.

RENDITJA E UEFA-s

Fundosen klubet milanezë, buzëqeshin Juventusit e Napoli

Në pritje të Kupës së Botës ka ardhur koha për bilance në klubet kryesore të futbollit evropian. Pas finales së "Champions League", e fituar përsëri nga Real Madrid, UEFA ka analizuar ecurinë e skuadrave italiane duke marrë në konsideratë renditjen e 10 viteve të fundit. Nga 2008 deri në 2018, gjërat kanë ndryshuar shumë për ekipet që kanë marrë pjesë rregullisht në kompeticionet evropiane. Nëse në fillim dominonin milanezët, sot janë Juventusit dhe Napoli më të mirat e Italisë në Evropë. Renditja e UEFA-s nga



2008 deri në 2018 flet qartë për dy ekipet e Milanos. Nëse kuqezinjët kanë kalua nga vendi i pestë

në të 53-in, kushërinjtë zikaltrit kanë kaluar nga i 11-ti në të 83-in (pozicionimi më i keq në dhjetë

vitet e fundit). E kundërta ka ndodhur me Juventus, që ka kaluar nga vendi i 24-t në atë të pestin. Ecuria më e mirë e dhjetëvjeçarit. Megjithatë, mbetet akoma larg podiumi i përbërë nga Real, Atletico Madrid dhe Bajern Munihi, që ndiqen nga Barcelona. Por nuk është vetëm Juventus që buzëqesh në Itali. Edhe Napoli, në fakt, ka bërë një kërcim të madh, duke kaluar nga vendi i 113-të në atë të 17-in (96 pozicione). Lajme të mira edhe për Roma-n, që ka shkuar nga vendi i 21-të në atë të 14-in.

PËR SHKAQE SIGURIE

Anulohet ndeshja mes Izraelit dhe Argjentinës

Argjentina ka anuluar atë që duhet të ishte miqësorja e tyre e fundit në kuadrin e përgatitjeve për Kupën e Botës 2018, e programuar për të shtunën në Jerusalem. Ndeshja duhet të zhvillohej në stadiumin "Teddy Kollek" dhe do të ishte testi i fundit për "çelëstët" para fillimit të Botërorit në Rusi, por nuk do të zhvillohet për arsye sigurie. Situata u tensionua edhe më shumë në momentin që presi-

denti i Federatës Palestineze të Futbollit i bëri apel të gjithë tifozëve Palestinë të digjin fanellën e Lionel Messit, pasi Argjentina nuk kishte pranuar ftesën e Palestinës për të luajtur me Izraelin. Ndeshja duhej të zhvillohet në perëndim të qytetit të Izraelit, një zonë pa palestinezë, por gjithsesi rreziku ishte shumë i lartë. Menjëherë pasi u mësua vendimi i argjentinase për të mos shkuar në Izrael,

palestinezët filluan të festojnë në rrjetet sociale. Kësaj, pasi fitoi 4-0 në miqësoren e parë ndaj Haiti, me tre gola të shënuar nga Messi, Argjentina do të shkojë direkt në Botëror. Pra, jo me të gjitha testimet e nevojshme para veprimtarisë në Rusi. Messi dhe shokët e tij janë në të njëjtin grup me Islandën, Nigerinë dhe Kroacinë, në atë që quhet "grupi i hekurt" i veprimtarisë.





DASHI 21. mars - 20. prill

Ky është një moment i rëndësishëm për të mbyllur disa çështje të së kaluarës dhe për të nisur të mendoni në mënyrë aktive për të ardhmen tuaj profesionale. Mundohuni të jeni të përqendruar lidhur me propozimet e marra së fundmi dhe mendohuni mirë para se të bëni një zgjedhje. Në mbremje parashikohet një zgjim i fuqishëm ndjenjash.



DEMI 21. prill - 21. maj

Mundohuni të keni simpati edhe me armikun, sidomos nëse e keni domosdoshmëri bashkëpunimin me të. Në dashuri ky është një moment shumë i mirë për të harruar zhgënjimet e së kaluarës dhe për të gjetur shpirtin binjak.



BINJAKET 22. maj - 21. qershor

Hijeshia juaj do të jetë maksimale dhe kjo gjë do ju lejojë që të bëni për vete persona të rinj, jo vetëm në fushën sentimentale, por edhe në atë profesionale. Mos u druani të riktheheni në lojë. Jini më të gatshëm dhe të lirshëm.



GAFORRJA 22. qershor - 22. korrik

Do të jeni shumë të shqetësuar edhe për gjëra jo shumë urgjente dhe të komplikuar. Ankthi së fundmi ju ka bërë shumë nervoz, ndaj kini kujdes në raportet ndërpersonale. Dëgjoni më shumë këshillat e personave që ju rrethojnë.



LUANI 23. korrik - 22. gusht

Kursejeni disi mendjemadhësinë, pasi nuk është kjo mënyra për të treguar besim në veten tuaj. Sjellja juaj do ju lejojë që të ecni në punë, por mundohuni që të mos i vini nën presion kolegët.



VIRJERESHA 23. gusht - 23. shtator

Kjo e mërkurë do të jetë mjaft e favorshme për të mbyllur me sukses një bashkëpunim mjaft stimules. Edhe në dashuri do të ketë zhvillime të mëdha. Tregohuni të gatshëm të përballeni me ndryshime të shumta.



PESHORJA 24. shtator - 23. tetor

Mundohuni të silleni me më shumë diplomaci, sidomos nëse keni të bëni me kolegë shumë të ndjeshëm. Nga pikëpamja sentimentale, kjo javë do të jetë shumë intensive dhe e mbushur me takime.



AKREPI 24. tetor - 22. nëntor

Mundohuni që të mos e cenoni shëndetin tuaj, për shkak të sforcimeve të tepërta në vendin e punës. Në këtë moment do të jeni të dërrmuar dhe do të keni shumë nevojë për pushim. Gjatë kësaj dite mundohuni të shmangni konfliktet në dashuri.



SHIGJETARI 23. nëntor - 21. dhjetor

Këshillohet që të jeni më pak krenarë gjatë kësaj të mërkure dhe sidomos, bëni mirë të përleni dhe të pranonin gabimet që keni bërë së fundmi. Në punë, do të ketë ngadalësi të ndjeshme.



BRICJAPI 22. dhjetor - 20. janar

Në dashuri kjo është periudha më e favorshme për të zyrtarizuar një lidhje. Gjithsesi duhet të jeni të përgatitur për t'u përballur me disa pengesa të vogla në vendin tuaj të punës, sidomos sa u takon parave.



UJORI 21. janar - 19. shkurt

Kjo ditë do ju favorizojë maksimalisht në çdo drejtim, por do ju duhet të bëni ndonjë sakrificë më shumë. Ky është momenti për t'u rikthyer në lojë dhe për të riparë disa bashkëpunime interesante. Në dashuri parashikohet një takim i rëndësishëm.



PESHQIT 20. shkurt - 20. mars

Nëse nuk ndiheni plotësisht të kënaqur me rezultatet e arritura deri më tani, do të gjeni gjithsesi mënyrën për të riparë projektet tuaja. Shmangni lodhjet e tepërta dhe vëproni me maturi.

Mensur Mamuti	KËNGË E KËNGËTARIT NE FOTO QË NUK KUSHTON SHUMË	N	LAG ME UJË BIMËT E MBUELLA TRASTË E MADHE PREJ PËLHURE	U	SHTESË (HUAJ)
KËNGË E KËNGËTARIT NE FOTO					
TEOLOGJIA ISLAME (AKIDE)					
PAGESË ME AFATE					
VEND BETEJE					
F				TEMPERATURA SHTYPJA	
SHKOLLA TEKNIKE			NUMRI I LUDOLFIT VATRA		
GJILPËRË PËR QENDISJE				VOLTI KRAHINË NË VOJVODINË	
VENDLINDJA E KËNGËTARIT NE FOTO GYP NIVELIZIMI					
Q					FUTBOLLISTI BELLORUSIAN, GENADI
DISENATORIA FRENËGE, KOKO					
NDJENJAT E KËNAQËSISË					KËNGËTARI NE FOTO
G					KOHA
ROLETA					
MESHKLUT E PATES, PATOKET					BABA
GIGAPASKAL					
NGADALËSIM SHPEJTESISË ME FRENA					
TRYEZAT E UHQIMIT					
I LARMË, LARAGAN, ME SHUMË FYTYRA					
KOHA	FRYT I NGJASHËM ME ARONINË DHE BORONICËN (SH.)				
FUTBO LLISTI KOLLASHINAC					
MONOKSIDI I SULFURIT			KËNGËTARIA PERISTERI FLORI		
I MOSHËS SË RE					
FUTBOLLISTI ESTONIAN, JAGER					
KITARISTI AMERIKAN, XHOZEZ				DJALI I JUDËS (SIPAS BIBLËS) A.Ë.	
S					
Ë. R.					ENERGJIA
D.Ë.			FAT I MIRË, RISKU		



NE KETE DATE

7 QERSHOR 1940

ZGJIDHJET: N, U, PUTHJA, AKAI, KËSTI, FUSHË, T, SHT, P, TËG, V, UELLSI, QEPAR, SHANEL, ËZIMET, GPA, MAK, SOFRAT, KULUMRITË, SO, ANKHELA, ENAR, ONANI, SATRIANI, ËR, DË, KISMETI.

Shumë i lehtë **Sudoku** **mesatar**

		2	1	6	8	3								9				
	9									9	3	8		6				
							2		7			2	1				6	
7					2	5								5				
5			8			6					1		6		3			5
2			7	1						8				7				1
3		5										6			4	8		
									8					9		4	2	5
		6	3	8	2	7				7								1

Shumë i lehtë: 472168395, 693257148, 851943267, 739425816, 514836972, 268719534, 385671429, 127594683, 946382751. Mesatar: 167428539, 938567142, 452139687, 673851294, 219643758, 845972361, 596214873, 381796425, 724385916.

Arbitrit e Botërorit do veshin Adidasin nga Bosnja



Këpuçë futbollit për gjyqtarët në Kupën e Botës "Rusi 2018" po prodhohen në fabrikën Sanino në Bosnje-Hercegovinë, e cila në 18 vjetët e kaluar ka punuar për kompaninë gjermane Adidas. Kjo është hera e parë që gjiganti i veshjeve sportive e ka lënë gjithë procesin e prodhimit në një kompani nga Bosnja.

Gjatë ndeshjeve për Kupën e Botës, që do të zhvillohen nga 14 qershori deri më 15 korrik në disa qytete të Rusisë, 36 gjyqtarë dhe 63 ndihmës të tyre do të veshin këpuçë speciale të bëra në Bosnje. "Për Kupën e ardhshme Botërore, që do të zhvillohet në Rusi, kemi bërë 351 palë këpuçë futbollit", tha Sanja Pazhureviç, shefe e prodhimit në fabrikën Sanino. Mirosllav Maziç nga Serbia dhe Damir Skomina nga Sllovenia janë të vetmit gjyqtarë nga ish-Jugosllavia që do të marrin pjesë në lojërat e kampionatit, ndërsa Dalibor Gjurgjeviç dhe Milovan Ristiç, të dy nga Serbia, do të jenë gjyqtarë ndihmës.

Me tre kamera? Ja si do të jetë Samsung Galaxy S10



Galaxy S10 pritet t'i sfidojë të gjithë smartphonet përsa i përket fotografisë. Sipas analistit KBI Securities Kim Dong-won, Samsung ka në plan të "ri-forcojë" biznesin e saj duke shtuar kamerën e trefisht në lançimin e ardhshëm të Galaxy S10. Smartphone tjetër, Huawei P20 Pro, përmban një aparat fotografik me tre lente që i bën fotografitë më të qarta dhe më të freskëta. Nëse Samsung Galaxy S10 i ri ka të njëjtin instalim si Huawei P20 Pro ne mund të presim një sensor kryesor 40MP, sensor 8MP sekondar dhe një sensor 20MP monokrom. Aftësitë shtesë të ndjeshmërisë së thellë të këtij Samsung Galaxy S10 duhet të ofrojnë gjithashtu fotografi ultra të qarta me cilësi të lartë si dhe kjo kamerë duhet të ofrojë zmadhim të madh optik. Samsung thuhet se do të lançojë Galaxy S10 në janar të vitit të ardhshëm.

Sëmundja e frikshme që po vret gratë

Sëmundja pulmonare obstruktive kronike (SPOK) është konsideruar gjithmonë si sëmundje e meshkujve, ndërkohë që aktualisht po vret më shumë gra sesa burra. Gati 8% e grave në Amerikë janë diagnostikuar me këtë sëmundje, ndërsa burrat nën 6%. Duke qenë se SPOK është lidhur shpesh me burrat, gratë diagnostikohen zakonisht pasi sëmundja ka avancuar. Simptomat e SPOK janë kolla kronike, teshtima, shtrëngime në kraharor dhe vështirësi në frymëmarrje. Aktualisht nuk ka një kurë të veçantë për sëmundjen pulmonare obstruktive kronike, megjithatë mund të nga-

dalësohet përkeqësimi i saj. Gjëja më e rëndësishme që duhet të bëjnë pacientët e diagnostikuar me SPOK është të heqin dorë nga duhan, raporton "WebMD". SPOK është termi që përfshin disa sëmundje të rënda të mushkërive, si bronkiti kronik, emfizema dhe gjendje të tjera që vështirësojnë funksionimin e mushkërive. Përveç duhanpirjes, faktorë të tjerë si ndotja e ajrit dhe gjenetika mund të kontribuojnë në zhvillimin e kësaj sëmundjeje. Gratë janë më të rrezikuara se burrat që të kenë përkeqësim të gjendjes si pasojë e infeksioneve ose ekspozimit ndaj ndotësve të ajrit.



Marihuana mund ta shërojë ekzemën



Marihuana mund të jetë e nevojshme për trajtimin e simptomave që ndërliken me sëmundjet e lëkurës, duke

përfshirë ekzemën dhe psoriasisin. Bima kanabis sativa njihet për agjentin psikoaktiv THC që gjendet në të, e i cili shkakton efekt intoksues. Sidoqoftë, me rritjen e numrit të shteteve të Amerikës që e legalizojnë apo dekriminalizojnë marijuanën, doktorët dhe pacientët janë duke shfaqur një rritje interesimi për përfitimet shëndetësore të bimës. Hulumtuesit kryesisht janë duke u përqendruar në katër agjentë tjerë që gjenden në këtë bimë, e të cilët mund të përdoren për probleme të ndryshme shëndetësore.

Këta katër agjentë janë: kanabidioli (CBD), kanabikromeni (CBC), kanabigeroli (CBG) dhe kanabinoli (CBN). Agjentët e lartcekur nuk e bëjnë përdoruesin të ndihet i droguar, por shkaktojnë lehtësim të dhimbjeve nga probleme të ndryshme shëndetësore, në mesin e të cilave është edhe ekzema. Vlen të ceket se ekzema është sëmundje e cila e shkakton lëkurën të pezmatohet, skuqet dhe çahet. Ndonëse ka shumë trajtime për ekzemë, ende nuk ka ndonjë kurë për këtë sëmundje.

1099 - Ushtarët e parë të kryqëzave arrijnë në Jerusalemin
1340 - Themelohet qyteti i Rotterdamit në Holandë
1413 - Mbreti Ladislav i Napolit okupon Romën
1494 - Traktati i Tordesillas: Spanja dhe Portugalia ndajnë Amerikën
1527 - Papa Klementi VIII dorëzohet ushtrisë së Perandorit Karlit V
1546 - Anglia nënshkruan marrëveshjen e paqes me Skocinë dhe Irlandën
1557 - Anglia i shpall luftë Francës
1654 - Luigji XIV kurorëzohet si Mbret i Francës
1775 - Kolonitë e Bashkuara ndërrojnë emrin në Shtetet e Bashkuara
1863 - Meksiko Siti okupohet nga trupat franceze
1929 - Vatikani shpallet shtet i pavarur
1955 - Aizenhauer, Kryetari i parë që u paraqit në televizor me ngjyra
1955 - Kryeministri i Indisë Nehru viziton BRSS
1982 - Kryetari Regan takon Papa Xhon Palin II dhe Mbretëreshën Elizabeta

KALENDARI HISTORIK 7 QERSHOR

Njerëzit mund të jetojnë pa stomak, me 75% të mëlçisë, një veshkë, 80% të zorrëve, një mushkri - kjo nuk do të jetë jeta më e lumtur, por është e mundur.



Njerëzit mund të mbijetojnë më gjatë pa ushqim se sa pa gjumë. Mund të jetojmë rreth 3 javë pa ngrënë, por pas 11 ditësh pa gjumë, trupat fillojnë të mbyllën.

UNAZA E VJEDHUR

Kishte ndodhur një vjedhje unaze dhe i pandehuri ishte thirrur në gjykatë!
Gjykatësi: Pra ti e vodhe atë unazë...
I pandehuri: Jo unë nuk e vodha por e gjeta.
Gjykatësi: Po pse nuk e dorëzove në polici?
I pandehuri: Nuk e dorëzova, sepse në të shkruhej "Përgjithmonë e Jotja".



Është mirë që në jetë, ashtu si në një banket, mos çohesh nga tavolina as i etur dhe as i dehur.
(Margaret Thatcher)

A E DINI SE...
BARSOLETA
THËNIA E DITËS